U-4275

JUL QESARI

LIBRARIA LETRARE
VELLIM II

WILLIAM SHAKESPEARE

JUL QESARI

E SHQIPËROJ FAN S. NOLI
E SHTYPNE SHOKET E AMERIKES

BRUXELLES, 1926

WILLIAM SHAKESPEARE

JUL QESARI

E SHQIPËROJ FAN S. NOLI

Ribotoi
„MUSTAFA BAKIJA“
PRISHTINË, 1953

Liberatórëve të Kombit
Dhe Martirëve të Çështjes
Me Lotë dhe Admiratë
Për Kujtím e Mirënjohje.

INTRODUKTË

„ Jul Qesari " u-shkrua në mes të viteve 1599 dhe 1601. Subjekti me pak fjalë është ky: Republikanët, të udhë-hequr prej Brutit dhe Kasit, vrasin Jul Qesarin, diktatorin e Romës, dhe ristorojnë Republikën; Mark Antoni me Oktavin, të nipin e Jul Qesarit, i shtrëngojnë Republikanët të ikin prej Rome dhe e dërmojnë ushtërinë e tyre në bëtejën e Filipit; Kasi dhe Bruti, që të mos bien në duar të kundrështárëve, vrasin veten njëri pas tjatrit; Republika Romane kthehet përfundërisht në diktaturë autokratike.

Të gjitha ngjarjet dhe personat e dramës, me përjashtimin e Lucit, shërbëtorit të Brutit, dhe të ca hollësive dhe anakronízmave pa rëndësí, janë kopiuar besnikërísht nga „Jetët Paralele" të Plutarkut, të përkthýera nga gërqishtja n'Inglishten prej North-it më 1579. Shakespeare-i nukë bëri tjetër veç se t'i dramatizonjë, po i ka lidhur aqë bukur sa ka krijuar veprën theatrale më të fortë të botës dhe e ka sinthetizuar këtë periudë të historisë romane aqë mjeshtërísht sa „Jul Qesari " i tij i shkurtër vlen më tepër se duzina vëllimesh mi këtë themë prej historianësh të specializuar.

Karakterizata e Jul Qesarit është kritikuar përgjithërísht që nuk i përshtatet historisë, po sa për këtë pikë s'kemi aspak arësye t'i biém më qafë dramatistit inglís. Ésht e vërtetë që diktatori i Romës s'ka qënë pafllatár e mburravéc i zbrazët po, pas dëshmimit të Plutarkut, duket se ishte bërë në vjetet e tij të funtme ashtú si na e përshkruan Shakespeare-i. Një shëmbëll të një ndrrimi anallóg kemi dhe në fytyrën e Napoleonit të Math. Si Jul Qesari, dhe ky e nis karierën e tij si gjenerál e konsul i një Republike dhe mbarón si tirán dhe autokrát i saj, i math në disá pika, po nga ana tjatër, si na e thotë bukur Anatolè France-i, në shumë pi-

ka fare si një foshnjë, që s'durón gjysmë fjalë kundrështimi. Që të dy, pas vijtóreve dhe suksèseve, fryhen nga fuqia, foshnjërohen nga lajkat dhe bëhen e kúndërta e asáj që kishin qënë në krye. Muzikanti i math Beethoven kish të drejtë kur ia dedikój Simfoninë Heroike Napoleonit, si një kryetrimi liberatór, po kish prapë të drejtë dhe kur e prishi këtë dedikatë nga dorështkrimi i tij, passí Napoleoni u-bë diktatór dhe shtypës i lirive. Ashtú dhe Shakespeare-i nukë humbét kurrë rasjen që të çfaqë admiratën për Jul Qesarin, gjeneralin ngadhënór të botës dhe përhápësin e qytetërisë romane, po me gjithë këtë na e paraqít në këtë dramë si një tirán grotésk me gjithë cenet e tij, si një karikaturë të vetes tij, dhe u jep të drejtë Brutit dhe Kasit, që e vranë për të çliruar atdhenë dhe për të shpëtuar Republikën.

Vërejtja e një kritiku, që Shakespeare-i na e nxier mi shkenë Jul Qesarin vetëm e vetëm që të vritet prej Republikánëve, nuk është shum' e drejtë, po s' dó fare bisedím që Jul Qesari nukë e lot në këtë dramë veç se një roll sekondár dhe ahere vijnë menjëherë pyetjet : Përsé kjo dramë ka emrin e tij për titull dhe jo emrat e Brutit e të Kasit që janë protagonistët e saj? Përsé kjo dramë, që është dithyrambi panegjirík i liberatórëve revolucionarë, mban etiketën e një tirani? Për këtë janë dhënë prej kritíkëve shpjegime të gjata dhe të holla, me të cilat nukë duhen lodhur këndónjësit, se janë pak a shumë dyshimta. Është më tepër për të besuar që Shakespeare-i, si një *businessman* anglosaksón praktík, e zgjodhi këtë titull se binte më tepër në sy për rekllamë; nga ana tjatër, me që rronte në periudën autokratike të Elisabetës e të James-it I, preferój flámurin e një tirani që të mos dukej sikúr merrte anën e liberatórëve republikanë;dhe nofta për këtë shkak vajti pikë për pikë pas historisë — gjë që nuk e bën fare në dramat e tij historike të tjera — që kështú, kur t'i binin më qafë monarkistët dhe absollutistët, t'ia hithte fajin Plutarkut të Kheronisë. Trike të këtija kanë bërë shkrimtarë të dëgjuar përpara dhe pas Shakespeare-it, po askúsh nuk e

ka mpleksur punën me një mënyrë dipllomatike aqë të hollë sa t'ua turbullonjë mëndjen jo vetëm këndónjësve të kohës tij po dhe atyre të kohës sonë. Ká me duzina kritikë seriozë modernë, të cilët pa nënëqeshur na thonë se Shakespeare-i ka dashur të na tregonjë në këtë dramë që vrasja e Jul Qesarit ishte një krimë çnjerëzore dhe një gjak-derdhje e kottë. Këtá kritikë tepër modernë harrojnë që Shakespeare-i është një njerí i shékullit të gjashtëmbëdhjetë, kur njerëzia nuk i gjykonin vrasjet politike pas standárdeve të sotme; që karakteristika kryesore e shékujve të Përlindjes është shtudimi dhe kullti i qytetërisë greko-romane; që subjekti i dramës është román dhe fryma e saj duhet të jetë romane; dhe që, pas standárdeve të botës republikane të Greqisë e të Romës së vjetër, vrásësit e tiránëve lavdëróhëshin si kryetrima liberatorë dhe vrasja e tiranit quhej një vepër e lartë dhe një detyrë patriotike e çdo qytetari të lirë. Sa për argumentin që kjo gjakderdhje na paraqitet si e kottë, posá Qesarizma dolli fitónjëse edhé pas vrasjes së Jul Qesarit, na e jep përgjígjien vetë Shakespeare-i me gojën e Brutit e të Kasit, kur na thonë që vepra e tyre do të mbetet si një shëmbëll në historí dhe që emrat e tyre, si liberatorë t'atdheut, do të përmënden jetë pas jete prej brézave të pastajmë në çdo gjuhë e në çdo shtet të botës.

Bruti dhe Kasi përfaqesojnë dy shkolla politike, dy sisteme revolucionare krejt të ndryshme sa për methudën që duhet vazhduar për t'arrirë në lirí me suksés. Janë plotërísht në një mëndje që çapi kryesór, domethënë rrëzimi i regjimit tiranik, duhet bërë me çfarëdó mjet pa mëshirë e pa shkrúpulla morale. Sa për këtë pikë merren vesh menjëherë pothua pa e vënë çështjen as në bisedím. Po, pas çapit kryesór, që në këtë rasje është vrasja e Jul Qesarit, Bruti dhe Kasi ndahen.

Kasi ësht i mëndjes që duhet vajtur drejt në qëllím nga udha që shpie më shpejt, me sá më tepër shokë e me çdo mjet, pa vënë re hollësira, pa mëshirë e pa shkrúpulla morale gjer në funt. Duhen qëruar të gjithë

gjëmbat dhe shtypur të gjith' atá që munt t' i zënë vëndin tiranit me një kundër-revollución, se është më mirë të bëhen disá vrasje të panevójshime se sa të lihet pa bërë një vrasje e domosdoshme për të mirën e përgjithëshme, dhe përandáj shkel këmbë në këtë rasje që të eliminohet bashkë me Jul Qesarin dhe miku i tij i ngushtë Mark Antoni. Kundrështarët duhen nxirë me gjithëséj në sy të pópullit, ky duhet ndezur kundër syresh me çfarëdó propagandë, dhe përandáj nukë duhet lënë me asnjë mënyrë t'ia trubullonjë mëndjen Mark Antoni me një fjalë funerale lëvdatore për Jul Qesarin. Duhen përdorur në çapet e para të gjithë njérëzit që munt të hyjnë në punë makár për emër, si Ciceroni, duhen sá më tepër shokë, të fituar makár me interés e me ryshfét, makár për kallaballék, se është rezík mos hidhen nga ana e kundrështárëve. Duhen ca muamelera makár të shëmtúara dhe ca daínj makár derra gjer sa të kapërcehet lumi, dhe në periudhën kritike jo vetëm nukë duhen vënë re paudhësít' e shókëve, po përkundër duhen mbuluar, dhe përandáj shkel këmbë që të falet Luc Pella, i kallëzuar për ryshfete dhe vjedhje. Parát' e nevójshime duhen mbledhur me çfarëdó mënyrë dhe kú të jet' e mundur pa dobësira sentimentale makár nga pópulli i varfer, se ndryshe ngec e tërë puna. Shkurt, për të shtypur tiranët, duhen përdorur mënyrat që përdorin atá vetë për të shtypur pópullin dhe mprójtësit e lirive të tij, siç bënë për shëmbëll pastáj Mark Antoni dhe Oktavi.

v Bruti është i mendjes që, për t' arrirë në lirí me sukses, duhet vajtur nga udha që shpie më shigurísht, me shokë të zgjedhur dhe me mjete bujare, se pópulli nuk e sheh qëllimin, as u jep rëndësí etiketës dhe retorikës, po i gjykón politikanët pas shokëve, pas mjéteve dhe pas púnëve. Nukë duhen bërë gjak-derdhje të panevójshime, se ahere liberatorët do të duken në sy të pópullit si kasapë dhe, në vënt të dashurisë, do të fitojnë antipathira të rezíkshime, dhe përandáj ndalón vrasjen e Mark Antonit dhe çfarëdó vrasje tjatër. Pópulli duhet ndri-

çuar për të njohur të mirën e tij, duhet enthusiazmuar për çështjen e lirisë, duhet frymësuar me besím në liberatorët e tij, dhe ky qëllím nuk arrihet me gënjeshtra a me nxirjen e padrejtë të kundrështárëve, dhe përandáj i jep leje Mark Antonit t'i mbanjë fjalën funerale Jul Qesarit me konditën që të mos i kritikonjë revollucionarët, që e vranë vetëm për ambicjen e tij. Duhen shokë të mirë, besnikë dhe të dishiplinuar, të fituar për çështjen, për interesin e përgjithëshmë, se shokët e liq, të rekrutuar me interesa të veçanta, me rogë a me ryshfete, dezertojnë shpejt a vonë, posá të shohin avanta më të mëdhá gjetkë, janë gjyle nër këmbë në çdo çap për vepërím dhe diskreditojnë tërë grupin në sy të pópullit. Parát' e nevójshime duhen mbledhur pa rjepur pópullin e vogël, se ahere do të duken në sy të tij si plaçkitës e jo si liberatorë, dhe atá prej shókëve që e bëjnë këtë gjë, si Luc Pella, duhen punitur e larguar nga partia. Shkurt, ashtú si ndryshón qëllimi i liberatórëve nga aý i tiránëve, ashtú duhet të ndryshojnë dhe shokët, mjetet dhe punët e tyre, që kështú pópulli t'a shohë menjëherë ndryshimin e njérësve e të sistemit, t' u japë besím liberatórëve dhe t' i ndihmonjë me gjithë zëmër për t' arrirë qëllimin me sukses.

Shakespeare-i na i përshkruan të dy sistemet me aqë drejtësí, simpathí dhe objektivitét sa ësht' e pamundur të thuhet cilin prej të dyve preferón. Nofta besonte që duhet përdorur njëri a tjatri, a një sistém i mesmë, si pas rasjes, nevojës a pópullit, po kjo natyrísht është vetëm një hipothezë. Sidó që të jetë, munt të thuhet përgjithërísht se që të dyja shkollat janë praktike dhe shpien në suksés po, sikundër na mësón historia, suksesi i sistemit të Kasit, m' i shpejtmë dhe m' i lehtë në krye, ësht' i pashigurtë dhe rrallë qëndrón më këmbë pastáj, kur suksesi i sistemit të Brutit, m'i ngadalmë dhe m'i rëndë në krye, ka baza prej çeliku dhe rrallë tundet a rrëzohet pastáj. Kjo munt të nënëkuptohet dhe prej kësáj drame, ku e shohim që vetë Kasi i unjet sistemit dhe udhë-héqies së Brutit. Gjithashtú munt të nënëkup-

tohet që lajthimet e këtí dhe mungesat e sistemit tij i shpien Republikanët në katastrofë, po për të kundërballancuar këtê përshtypje, Shakespeare-i na tregón disá fakte, të cilat e súallë kryesísht katastrofën dhe për të cilat s' ka faj as Bruti as methuda e tij. Dhe në këtê gjë Shakespeare-i vete pikërísht pas Plutarkut, i cili vërtét e quan mos-vrasjen e Mark Antonit si lajthim të parë dhe lejen e fjalës funerale prej këtí për Jul Qesarin si lajthím të dytë të Brutit, po shton me shumë të drejtë se që të gjitha, fati, rasjet dhe perënditë u-kthyen kundër Republikánëve.

Gjer më një pikë Bruti dhe Kasi janë dy vllezër binjakë dhe shëmbëllejnë me njërjatrin si dy pika uji: Që të dy janë frymësuar me zjarrin e shenjtë, me idealin e lirisë, me dashurín' e atdheut, n' alltarin e të cilit sakrifikojnë çdo interés privát e çdo gjë të dashur; që të dy e ndjejnë për detyrë supreme të lëftojnë gjer në fund për të mirën e përgjíthëshme të pópullit; që të dy janë njerës praktikë dhe të mprehtë të punës: që të dy, si herónj të vjetërisë kllasike, janë të mëndjes që trim' i mirë duhet a të rronjë si burrë a të vdesë si burrë. Janë që të dy Romanë nga instinkti, po ndryshojnë nga edukata. Bruti është dishepull i shkollës fillosofike të Stoikëve, mësimet e së cilës pothua ujdisin plotërísht me traditat romane, po largohet prej saj në çështjen e vetë-vrasjes dhe, si Román kryelartër, preferón të vrasë veten se sa të zvarrniset i mundur pas qeres triumfale të tiránëve nëpër rrugët e Romës. Kasi përkundër është dishepull i shkollës fillosofike të Epikuriánëve, e cila pridikonte skeptikizmën dhe gëzimin e jetës, po në jetën praktike bën të kúndërtën: Është fanatík militánt i një ideali politík, për të cilin sakrifikón çdo gëzím të jetës; nukë dó as muzikë, as lodra, as qefe, as dárkëra; i mvrojtur e i thatë nga pamja, rrallë qesh, pó shtudión, observón, punón, lëftón, vuan dhe vdes si një martír për një fe, për të cilën arësyja e tij nuk ësht aspák e bindur. Nga kjo pikë-pamje është me tragjík se Bruti. Po nga kjo pikë-pamje Mark Antoni

është ca më tragjik se Kasi. Kur ky ësht' Epikurián vetëm në theorí, Mark Antoni ësht' Epikurián e Hedoníst në theorí e në praktikë. Esht' aqë pas lódrave, pas qéfeve e pas grave sa konsiderohet aqë prej mikut tij Jul Qesarit sa dhe prej kundrështarit tij Mark Brutit si një njerí krejt i pazoti për nonjë punë serioze. Kasi vetëm s' gënjehet, se di nga vet' e tij që instinkti është m'i fortë se edukata. Çvillimet e pastajme i japin plotërísht të drejtë. Mark Antoni, i kalbur nga veset, ka një dell burrërie, i cili kërkonte një rasje që të çfaqej dhe i cili shkrep si një meteór i ndriçim n'errësirën e natës e të furtunës. Vêreni re transformatën e këti njeriu. Kur Bruti dhe Kasi gatiten t' a vrasin Jul Qesarin, një prej shókëve revollucionarë e largón Mark Antonin nga Senati dhe pa fjalë e shpie më nonjë qef. Atjé, të kurorëzuar me lule, ia shtrojnë me të ngrëna e me të pira, me gra e me këngë e me valle. Në zjafét e sipër, Mark Antoni mësón lajmën e tmerruar të vrasjes së mikut tij. Çdehet, zgjohet, transfigurohet. I jep shkelmin sofrës, heth me njërën dorë kurorën e lúleve nga koka, largón me tjatrën hetairat e búkura që e rrethojnë, dhe shkon në shtëpí një njerí krejt i ndryshmë, një fytyrë heroike që del si me magjí nga kërma e një pjaniku. Rri pak, mejtohet, bën pllanin dhe e vë menjëherë në vepërím: A do t' ia marrë gjakun mikut, a do të vdesë pranë kufomës tij. Si Kasi, dhe Mark Antoni s' ka asnjë shkrupull morale dhe e quan të mirë çdo mjet për t' arrirë qëllimin. U bie nër këmbë revollucionárëve, u tregohet mik, merr lejen nga Bruti t' a varrosë Jul Qesarin e t' i mbanjë fjalën funerale, akseptón konditat e tyre dhe i shkel pastáj që të gjitha. Me kufomën e Jul Qesarit si aliát, togën e tij të çpuar prej kámave si një flamur të përgjakur në dorë, i patrëmbur kur të gjithë i ka zënë data, ia trubullón mëndjen turmës, i ndes larot kundër Republikánëve dhe e fitón tërë luftën. Kështú Mark Antoni nga sofra e qefit shkón në funerál dhe nga funerali në kundër-revollución e në triúmf. Kështú instinkti i tij román, i zgjuar béfas, bën çudira

të paprítura dhe në kundrështím të plotë me edukatën dhe zakonet e jetesës tij. Po që dhe këtó më në funt ia marrin gjakun instinktit, na e tregón Shakespeare-i në një dramë më të pastajme, ku e shohim Mark Antonin të vdekur në krahët e Kleopatrës.

Bruti dhe Kasi, vllezër binjakë nga instinkti dhe nga ideaiet, ndryshojnë jo vetëm nga edukata dhe nga sistemi i vepërimit, po edhe nga karakteri, nga temperamenti dhe nga zotësitë:

Bruti, i lindur për kumandár, është njerí me fjalë të paka, me vullnét të hékurtë, me nerva të çelnikta, i duruar në fat-keqësí, gjak-ftohtë në rezik, i shpejtmë si rrufé në vepërím. I ka dishiplinuar pasionet e veta dhe di t' a kontrollonjë veten aqë plotërísht sa s' tregón me asnjë shenjë të jashtme ç' vojtje e ç' luftë ka në zëmër të tij, si për shëmbëll kur përpiqet të fshehë nga shokët vetë-vrasjen e së shoqes tij së dashur, dhe kur e mban veten e s' qan mi kufomën e Kasit të vetë-vrarë që të mos i dëshpëronjë ushtarët, me të cilët bën sulmën e funtme kundër tiránëve. Vetëm tërthori na lë të kuptojmë që ka furtunën në kokë dhe zjarrin në krahërór, kur s'e zë gjumi e kërkón të këndonjë nonjë libër a të dëgjonjë pak muzikë, a kur i ka zilí Lucit, shërbëtorit tij, që e sheh të flerë i qetë dhe i çkujdesur. Ka besím absollút në idealin e tij, në sistemin e tij, në veten e tij dhe ësht' aqë i kthjellët, i pastër, i painteresmë, bujár dhe i drejtë sa jo vetëm shokët dhe pópulli i binden me respékt, po dhe kundrështarët e tij janë të shtrënguar t' ia njohin sinqeritetin e t' a lavdërojnë pas vdekjes si një burrë në tërë kuptimin e fjalës. Di sí të fitonjë miq dhe t'i ngjitë pas vetes gjer në vdekje. Me ëmbëlsín' e gjenerálëve të mëdhénj, di sí t' i përkëdhelë ushtarët e t'i bënjë të sulen në zjarr nën' udhë-héqien e tij. Sá zëmër-mirë është, duket nga dashuria që i ka e shóqia dhe nga tmerri që ndiejnë shokët e tij, kur pas dishfatës së Filipit u lutet t'a vrasin e t'a shpëtojnë nga një jet' e padurúarshme.

Kasi s' ka fenë absollute, gjak-ftohtësinë, durimin, vetë-kontrollimin, vetë-besimin, lakonizmën, bujarësinë dhe ëmbëlsín' e Brutit, po e kapërcén nga zotësia organizatore, nga mjeshtëria propagandiste revollucionare, nga sqojtësia politike, nga eksperienca e jetës praktike dhe nga njohja e thellë e njérësve. Zëmërngushtë, nga frika se mos ishte zbuluar kompploti, sikúr të mos ia kishte mbajtur dorën Bruti gjak-ftohtë, do të kishte vrarë veten në Senát përpara se të vritej Qesari, dhe fund' i fundit vret veten në fushë të Filipit nga një moskuptím tragjík pa pritur të shigurohet sí kishte rrjedhur puna. Kur Bruti hesht, durón nënë një regjím tiraník dhe pret rasjen e favortë, Kasi preferón vdekjen nga zgjedha, pëlcét nga e kéqia, flet, punón, fitón shokë, vë zjarr, gatít kryengritjen e nésërme, e ka organizuar taborin revollucionár, e ka rrethuar tiranin me pusira më të djatht' e më të mëngjër. I urrën tiranët me tërë forcën e shpirtit, s'ka shkrúpulla, drejtësí a mëshirë për tá, është gatí të bëhet dy herë më tiraník se tá në methudat gjer sa t' i shtypë e t' i shúanjë nga faq' e dheut. Mjeshtëria dhe argumentat e tij për të ndezur kundër tiranit atá që kanë gjak prej burri të lirë janë të pakapërcýershme dhe munt të shërbejnë si një katekizmë për çdo agitatór dhe propagandíst revollucionár të çdo kohe. Di të zgjedhë njérëzit, mjetet dhe kohën për të mbaruar punën, di cilët prej kundrështárëve janë të rezikshim dhe duan qëruar. Kur Bruti dhe Jul Qesari vetë gënjehen për Mark Antonin, Kasi me syrin e tij prej shkabe njeh në fytyrën e tij njerinë që munt t'ua hanjë kokën të gjithë Republikáněve. Di sí munt t'i kapë e t'i fitojnë njérëzit: Brutin me patriotizmën, me detyrën, me traditat e shtëpisë tij, si stërníp të Jun

Brutit, që rrezój monarkín' e Tarkínëve dhe themelój Republikën e Romës; Kaskën, natën e furtunës së tmerruar, me supersticën, me zëmërimin e perëndive për arrogancën e tiranit dhe poshtërimin e Románëve; Mark Antonin, passí nuk i shkoj fjala që të qërohet, me proponime ofiqesh dhe ryshfetesh. Dyke shtudiuar njérëzit dhe dobësít' e tyre, është bërë pesimíst, s'i ka besím pópullit, të cilin e meprizón, s'ka asnjë shpresë nga Romanët e rinj, që u-bënë dhën përpara një ujku, dhe ka arrirë në konkluzjen që duhen çliruar me pahír, që duhen shtyrë me hostén a hequr me kapistáll në udhën e përparimit. Po ashtú sikundër s'u ka besim njérësve Kasi, ashtú s' i kanë besím as atá; pópulli ia ka frikën, kundrështarët ia kanë tmerrin, shokët ia kanë dyshimin. Po Kasi ashtú si njeh të tjerët njeh edhe veten e tij: di fare bukur ç'mejtím kanë të tjerët për të, di cenet e veta, di mungesat e sistemit tij, di që aý nukë duhet t'a heqë vallen si kryetár. Dhe këtú është bukuria e këtí idealisti revollucionár. Për hirin e çështjes, sakrifikón ambicjen e tij personale dhe, ndonësé është ushtár m'i vjeter dhe politikán m'i hollë, ndonesé aý e ka organizuar grupin revollucionár, ndonësé ka dyshime për sistemin e Brutit, e njeh këtê si kryetár qëkúr e fitój me anën e tij, i vihet nën' ùrdhërin dhe i bindet në të gjitha me disiplinën e një ushtari román. Kur i duket që methudat e Brutit shpin në katastrofë, protestón, ndizet, ulërín dhe dikúr jep përshtypjen sikùr do t'i vërvitet shokut. Aspák. Si nonjê djalë shkolle, i unjet mësónjësit, i bindet plotërísht, pastáj qahet që mësónjësi e qërtój tepër rëndë dhe mê në funt admetón që mësónjësi duhej t' a kishte vrarë për sjelljen e tij. Sá e çmonte Bruti këtê luán, të tmerruar

për tiranët po të zbutur për shokët e idealit, ia thotë pas vdekjes: „Ish i funtmi i Románëve!"

Sikundër thamë më sipër, Shakespeare-i, që të mos na lërë të kuptojmë që katastrofa e revollucionárëve ardhi nga lajthimet e nga sistemi i Brutit, na tregón tërthori po fare çkoqur arësyet kryesore, nga të cilat do të kishte ardhur katastrofa doemós. Këto qenë atituda e ushtërisë, e parësisë dhe pópullit:

Ditën që vritet Jul Qesari, ushtëria e të nipit tij Oktavit, ndodhet afër Romës dhe natyrísht veteranët e Jul Qesarit marrin anën e tij, kur anën e idealistëve republikanë e marrin djelmuria, shtudentët, poetët, artistët dhe intelektualët.

Ç'atitudë mbajtin parësia, duket nga sjellja enigmatike e Ciceronit. Ditën që i blatohet kurora mbretërore Jul Qesarit, të gjithë prisnin të dëgjonin ç'mejtohej për këtê çështje Ciceroni, oratori i dëgjuar dhe ish-kónsulli i Republikës Romane. Po ky pati frikë t' a çfaqë mejtimin e tij dhe foli gërqísht. Pópulli s' mori vesh as gjysmë fjalë dhe atá që dinin gërqísht e kuptuán, nënëqeshnë dhe tuntnë kokën. Ciceroni kish qenë dikúr trim në punë, përgjithërísht trim në fjalë, po këtê herë kish ngordhur nga të gjitha pikë-pamjet. Pas shëmbëllës tij u-súallë dhe të tjerët dhe ndënjnë të paánëshmë. Po paanësia nuk i shpëtój, se posá rá fuqia në dorë të Mark Antonit e t'Oktavit, Ciceroni e pagój fjalën gërqishte dhe atitudën e dyshimtë me kokën e tij. Ashtú e pësuan dhe shokët që e múarë për shëmbëll.

Pópulli ishte pa dyshím në favór të Republikánëve dhe kundër Jul Qesarit. Kjo duket çkoqur në shkenën e parë të kesáj drame, ku të dy tribunët Flavi dhe Marulli me ca qërtime e përndajnë dhe e dërgojnë në

shtëpí pópullin që ish mbledhur për të sallutuar Jul Qesarin. Pas vrasjes së këtí, pópulli e pret me enthusiazmë Brutin dhe s' dó të dëgjonjë as gjysmë fjalë kundër këtí nga goja e Mark Antonit. Po ky dinte të goditte pikërisht atjé ku i dhëmpte pópullit dhe ia ftoh enthusiazmën, dyke bërë që në krye të fjalës tij një alluzión ironík për shokët e Brutit. Sikúr të muntte të fliste hapur, Mark Antoni do t'u kishte thënë dëgjónjësve të tij shkurt e prerë e pa retorikë këtó: „Bruti ësht' i nderçim, po e kanë gënjyer shokët e liq; këtá e kanë vrarë Jul Qesarin nga inati personál dhe nga ambicja që t'i zenë vëndin e jo që t'a çlirojnë pópullin; pas Jul Qesarit zëmër-mirë, që e deshte pópullin, do të vinjë një tirán zëmër-lik si Kasi, të cilin e njihni fare bukur; nukë do të vinjë dot Bruti, se ky u-bë vegl' e verbër e Kasit, se ndryshe Bruti nukë do të ngrente kurrë dorën për të vrarë mikun e tij më të shtrenjtë, Jul Qesarin, i cili e deshte si ëngjëll; me vrasjen e Jul Qesarit dhe me hipjen e Kasit në fuqí, Roma u-prish e u-çkatërrua; dhe — „Ahere un'e ju e gjithë ramë, dhe na përmbyti tradhësí' e gjaktë!" Pópulli e mori vesh Mark Antonin menjëherë që nga alluzionet e para, sikundër duket nga eksklamata e një qytetari, i cili thotë që, pas Jul Qesarit, është frikë se mos vinjë nonjë m' i lik, domethënë Kasi. Nga ana tjatër, është një lajthím të besohet që pópulli republikán i Romës, antiqesarián sa rronte Qesari, pro-brutián enthusiastík pas vrasjes tij, u-kthye prej Mark Antonit si me magjí kundër liberatórëve dhe vete u djek shtëpitë. Këtë përshtypje na e jep Shakespeare-i vërtét, po është vetëm një illuzión dramatík i shkenës. Mark Antoni e mbarón punën ndryshe, prapa shkenës, me agjentët e

tij. Përpara se të mbanjë fjalën funerale, ka mësuar që ushtëria e Oktavit me veteranët e Jul Qesarit ndodhet në dyer të Romës; lëshón pra ca agitatorë, të cilët, dyke pëshpëritur në vesh më të djatht' e më të mëngjër lajmën e ardhjes së një ushtërie qesariane gjak-márrëse, nga njëra anë e trëmbin pópullin republikán dhe nga ana tjatër ndezin larot për kundër-revolución. Aqë pópulli sa dhe parësia e Romës përgjithërísht nukë janë ƒajtorë se e tradhëtuan lëvizjen republikane, po se ndënjnë mënjanë të ftohur a të terrorizuar dhe i lanë të vetëm e në baltë Brutin e Kasin. Këtê atitudë fatale e paguan shtrenjtë pastáj, dyke hyrë nënë një zgjedhë tiranie, të cilën e mbajtin brezat e pastajme mi zverk shekuj me radhë gjer sa u-çkatërrua e u-çdúk perandoria romane.

Berlin, mars 1926. **F. S. Noli.**

PERSONA TË DRAMËS

JUL QESARI.

OKTAV QESARI, MARK ANTONI, EMÍL LEPIDI — Triumvirë pas vdekjes së Jul Qesarrit.

CICERONI, PUBLI, POPÍL LENA — Senatorë.

MARK BRUTI, KASI, TREBONI, LIGARI, DEC BRUTI, METÉLL CIMBRA, CINNA — Konspiratorë kundër Jul Qesarit.

FLAVI, MARULI — Tibunë.

ARTEMIDORI, Sofist i Knidit.

NJË FALLTÁR.

LUCILI, TITINI, MESSALA, KATONI I RI, VOLUMNI — Miq të Brutit e të Kasit.

VARRONI, KLITI, KLAVDI, STRATI, LUCI, DARDANI — Shërbëtorë të Brutit.

PINDARI, Shërbëtór i Kasit.

KALFURNJA, e Shóqia e Jul Qesarit.

PORSHA, e Shóqia e Mark Brutit.

Senatorë, Qytetarë, Ushtarë, Gardianë, Pasonjës, etj.

Shkena. — Pjesa e madhe e lodrës në Romë; pastáj në Sard dhe pranë Filipit.

AKT I

SHKENË I

Romë. Një Rrugë.

Hyjnë FLAVI, MARULLI, *dhe disá* QYTETARË.

FLAVI.

Largóhuni, përtacë! Në shtëpí!
Mos ësht' e kremte sot? Apó s'e dini
Që nuk barisni dot, si punëtorë,
Në ditë punëtore pa emblemë
Për çdo zanát? Or ti, fol, ç'punë bën?

I PARI QYTETÁR.

Zot, jam strugatës .

MARULLI

Kú ke brushtellën e lëkùrt'e rigën?
Ç'po bën këtú me rrobat mê të mira?
Ti, ç'punë bën, or zot?

I DYTI QYTETÁR.

E drejta, or zot, përpara një punëtori të hollë si ky, unë s'jam veç, si të them, një arrnonjës.

MARULLI

Më thuaj ç'punë bën? Përgjígj-u shpejt.

I DYTI QYTETÁR.

Një punë, or zot, të cilën besónj që munt t'a bënj me ndërgjégjie të qetë, se me të vërtetë, or zot, ua ndreq mëkatárëve tabanet e shtrëmbëra.

MARULLI

Zuzár, zuzár i prapë, ç'punë ben?

I DYTI QYTETÁR.

Të lutem, zot, mos u'çír me mua; se, po të çiresh, munt të të qep.

MARULLI

Sí the, zuzár pa cipë? Të më qepësh?

I DYTI QYTETÁR.

Pó, zot, të t' i arrnónj këpucët.

FLAVI.

Mos je shollár, mor, apó jo?

I DYTI QYTETÁR.

Vërtét ashtú, or zot; rronj vetëm me gjëlpërýerin; ua qep búrrave dhe grave shollat. Me fjalë të tjera, or zot, jam xherahu i këpúcëve të vjetra; kur ndodhen në rezík të math, un'i shërónj; këmbët më të híeshme, që baresin në rrugët, kanë shkuar nga dora ime dhe ua kam mbathur unë këpucët.

FLAVI.

Po psé ke dalë nga dyqani sot?
Përsé i prin në rrugë këtá njerës?

I DYTI QYTETÁR

E drejta, or zot, që të grisin këpucët e të kem më tepër punë. Po, që të mos të gënjénj, or zot, kemi dalë të shikojmë Qesarin dhe të gezóhemi në triumfin e tij.

MARULLI

Psé të gezóheni? Ç'vijtore sjell?
Dhe ç'tributár'i vijnë pás në Romë
T'i zbukurojnë qeren triumfale?
Ju drurë, gurë dhe shkëmbínj pa ndjenja,

O ju, Romanë, pa shpirt e pa zëmër,
Pompeun nuk e njohtë? Oh, sá herë
U--ngjittë nëpër mure dhe fortesa,
Në tura, në dritare dhe në maja
Oxhakësh, me fëmijët në pëqí,
Dhe ndënjtë tërë ditën me durím
Pompén' e math t'a shihnit rrúgëve
Të Romës kur kalonte, dhe posá
I dukej qerja, klithmës ia kërrcisnit
Sa dridhej Tibri nënë shtrat të tij
Nga brohoria e përgjíthëshme,
Q' i oshëtinte nëpër breg e zall.
Dhe dilni sot me rrobat më të mira?
Dhe ditën sot e bëni një të kremte?
Dhe lule udhës shtroni për atë
Që triumfój mi gjakun e Pompeut?
Largóhuni!
Shkoni më shpi, më gjunjë perëndive
U lútuni murrtajën të ndalojnë,
Që turet mi këtë mosmirë-njóhje.

FLAVI.

Shkoni, ó miq, e lani këtë faj:
I mblithni vegjëlinë, shokët tuaj,
I shpini buzë Tibrit, derthni lot
Gjer sa të fryhet rrjedhja më e unjur
Edhé të puthë bregun më të lartë. *(Dalin QYTETARËT)*
Shih, zëmra plump e tyre u-zbút
E çduken si fajtorë gojë-kyçur.
Ti, zbrit andéj nga an'e Kapitolit,
Unë këtéj. Stolít'i çkul nga çdo
Piktúr'e Jul Qesarit që të gjesh.

MARULLI.

A munt t'a bëjmë këtë gjë?
E di që kemi Luperkalet sot?

FLAVI.

S' prish punë; s' duhet lënë varrur
Asnjë pikturë me tropé Qesari.
Unë shetít e zbonj nga rruga turmën;
Bëj gjithashtú kú t'i shikósh të mbledhur.
Kështú nga krahët shkabës Jul Qesár
Ia ndukim pëndet para se t'i rriten,
Dhe fluturón pa vrap, si zoqt' e tjerë,
Se ndryshe ngjitet përtéj pamjes syrit
Dhe na përmbán në frikë skllavërishte. *(Dalin.)*

SHKENË II

Gjithatjé. Një Shesh Publík.

Hyjnë me procesje dhe muzikë QESARI, ANTONI *i veshur për rendjen,* KALFURNJA, PORSHA, DECI, CICERONI, BRUTI, KASI, *dhe* KASKA; *një turm' e mdhe vjen pás, midís të cílëve një* FALLTAR.

QESARI.

Kalfurnjë!

KASKA.

Heshtni, ej! Qesari flet! *(Pushon muzikë.)*

QESARI.

Kalfurnjë!

KALFURNJA.

Urdhëró, Imzót!

QESARI.

Qëndró-i Mark Antonit tamán udhës
Në rendjen, kur të niset. Mark Antón!

ANTONI.

Qesár, Imzót!

QESARI.

Të mos harrósh në shpejtësí, Antón,
T'a preksh Kalfurnjën; se, si thonë pleqtë,
Beronja shkunt mallkimin e moslindjes,
Kur preket në këtê të shenjtë rendje.

ANTONI.

Do t'a mbanj mënt; Qesari kur më thotë
„Bêj këtê gjë!" u-bê dhe u-mbarua.

QESARI.

Nis pra; mos lër ceremoní pa bërë. *(Muzikë.)*

FALLTARI.

Qesár!

QESARI.

Eh, kúsh thërrét?

KASKA.

Pushoni çdo shamatë; heshtni prapë! *(Muzika pushon.)*

QESARI.

Kúsh më thërrét në mes të pópullit?
Një zë m'i mprehtë se muzika klithi:
„Qesár!" Fol; Qesari të dëgjón.

FALLTARI.

U-ruaj ídave të Marsit.

QESARI.

Kush ësht' aý njerí?

BRUTI.

Ky është një falltár; të porosít
Të ruhesh ídave të Marsit.

QESARI.

Përpara síllmani t'ia shoh fytyrën.

KASI.

Or zot, pa dil përpara Jul Qesarit.

QESARI.

Ç'më the tani? Fol prapë dhe një herë.

FALLTARI.

U-ruaj ídave të Marsit.

QESARI.

Është ëndërronjës; léreni; eh, shkojmë.
(Marsh. Dalin të gjithë veç BRUTIT *dhe* KASIT.)

KASI.

A do të vish të shohësh rendjet?

BRUTI.

Jo, nukë vinj.

KASI.

Të lutem, eja.

BRUTI.

S' m' i k' ënda lodrat; më mungón një pjesë
E gjallësisë që ka Mark Antoni.
Po të mos të ndalónj nga udha, Kas;
Ja ku të lë.

KASI.

Mark Brut, po të vë re taní në funt:
S'të ka për mua syri ëmbëlsinë
Dhe dashurinë që më kish një herë,
Dhe e shikón i mvrojtur dhe i huaj
Një mikun tënt, që po të dó.

BRUTI.

O Kas,
Mos u-gënjé; i vura cipë syrit
Dhe ktheva trubullimin nga fytyra

Përbrënda meje. Se që prej pak kohe
Më ngasin pasione kundrështare,
Mejtime, që përkasin vetëm mua,
Dhe nofta sjelljen pak m'a ngrysin.
Pra, s'duhet të helmohen miqt' e mi —
Dhe një prej syresh je dhe ti, ó Kas, —
As të m'a marrin mosvërejtjen ndryshe;
Se Brut'i varfër luftë ka me veten,
Dhe dashuri harrón t'u çfaqë miqve.

KASI.

Ahere, t'a kuptova mvrojtjen liksht;
Kështú në krahërór kam mbajtur fshehur
Mejtime dhe shtudime plot me vlerë.
Më thuaj, Brut, á sheh fytyrën tënde?

BRUTI.

Jo, Kas; se syri veten nuk e sheh
Veç me riflektë nga të tjera gjëra.

KASI.

Ashtú vërtét:
Dhe më vjen shumë keq, ó Brut,
Që s'ke pasqyrë që të të tregonjë
Në syrin vlerën tënde të mbuluar,
T'a shohësh hien tënde. Kam dëgjuar
Disá nga më të ndérçimit e Romës —
Përvéç Qesarit të pavdékëshmë —
Për ty të flasin e të dëshërojnë
Bujari Brut t'i kishte çelur svtë.

BRUTI.

Nëpër ç'rezike po më prin, ó Kas,
Që po më shtyn në shpirtin të kërkónj
Atê që nuk e kam?

KASI.

Ihere më dëgjó, i dashur Brut:
)he posá veten tënde s'e sheh dot,
'eç me riflektë, unë, si pasqyrë,
)o t'të zbulónj modeştërísht një anë
'ë vetes sate që s'e di ti vetë.
)he mos m'a merr për keq, i dashur Brut:
'o t'isha tallës i zakónëshmë,
)ë rekllamónj me bera dashurinë
Të blérësit e rinj; a në më ditsh
)ë përkëdhél e përqafónj këdó
)he e shkelmónj pastáj; a në më ditsh
)ë në dëfrím e dasmë vllazërohem
Me tërë turmën, rúaj-u prej meje. *(Trumbeta dhe brohorí*

BRUTI.

'sé brohoritin? Pópulli, kam frikë,
: zgjeth Qesarin, mbret.

KASI.

Ke frikë, the?
Ihere, s'të pelqén kjo gjë aspák.

BRUTI.

Aspák, po prap' e dua fort Qesarin.
)o kaqë gjatë psé më mban këtú?
:'gjë vallë dëshërón të më tregósh?
Të qoftë për të mirën e përgjithme,
Të njerin sy vër nder, në tjatrin vdekje,
)he pa ndryshím do t'i shikónj të dy.
)e, perënditë më ndihmofshin, dua
Më tepër nderin se ç'i ndruhem vdekjes.

KASI.

: di, ó Brut, e ke këtê virtýt
Të shpirt, siç di seç ke në trup përjashta.

Pra nderi ësht them' e fjalës sime.
S'e di ç'idé ke ti e bota tjatër
Për këtê jetë; sa për veten time,
Mê mirë vdes se rronj, kur të kem frikë
Nga një njerí tamám si unë vetë.
I lirë linda si Qesari; si ti;
Të dy po hamë bukë, dhe të dy
Po e durojmë dimrin si aý.
Një herë, në një ditë t'ashpër shqote,
Kur Tibr' i trubull rrihte, çirte zallin,
Më tha Qesari: „A kuxón, or Kas,
Të hídhemi mi këtó vala t' egra
Me not gjer m'anën tjatër?" Sa m'a tha,
Si qesh'i veshur, u-vërvita n'ujë
Dhe pás e ftova; pás, vërtét, më rá.
Buçiste lumi, e përçanim né,
E hithnim tej me mushklla sulmë-plote
Me zëmra sedër-plotë ia prisnim hovin;
Po, pa arrirë pikën ku qëllonim,
Qesari thirri: „Ndih-më, Kas, se mbytem!"
Dhe unë, si stërgjýsh' i math Enea,
Që përmí sup shpëtój nga flag' e Trojës
T'atin, Ankisin plak, ashtú nga valat
E Tibrit çkula Jul Qesár' e lodhur.
Dhe ky taní m'u-bê si perëndí,
Dhe unë s'jam veç krijatýr' e mjerë
Që duhet t'unjem kur aý lot syrin.
Ka patur ethe kur na ish në Spanjë,
Dhe kur e kapi e kéqia, vura re
Që dridhej; pó, na dridhej perëndia!
Nga buz'e ngordhur i kish ikur gjaku;
Dhe aý sy që botën tër'e tunt
Kish humbur dritën; pó, dhe regëtinte;
Dhe ajó gjuhë, q'urdhërój Romanët
T'a vënë re, t'ia shtypin fjalët' libra,
Ajmé, rënkonte: „Një nem Titín!"
Si goc' e mekur. Ju, ó perëndira,
Çuditem qýsh njerí si ky trup-dobët

Iu-súl mi supet botës madhështore
Dhe mbretërón mi tê pa shoq, i vetëm.

(Trumbeta dhe brohorí.)

BRUTI.

Po brohoritin prapë që të gjithë!
Më duket se dorë-trokitjet çfaqin
Q'u-rrít Qesari me të tjera ndere.

KASI.

Aý shetít taní te bot' e ngushtë
Si një Kollós; dhe né të végjëlit
Po i baresim nënë këmb' e shohim
Mos gjejmë nonjë varr pa nder për veten.
Likúr njeriu ësht'i zot'i fatit:
S'na kanë yjtë faj, i dashur Brut,
Po vetë né, që jemi zëmër-dobët.
Mark Bruti e Jul Qesari; ç'të ka ky?
Psé emr'i tij të tingëllín mê tepër?
Në shkresë, yt'i bukur sa i tij,
Në gojë, sa i tij i híeshm' yti,
Në pesh gjitháq'i rëndë; kungjëró-î
Dhe „Bruti" ngre shpirita sa „Qesari".
Taní, për përëndít' e gjitha bashkë,
Me sé ushqehet ky Qesari ynë
Që kaq' i math u-rrít? Turp ty, ó shekull!
Moj Romë, s'lintke bij bujarë më!
Që nga përmbýtj' e madhe e këtéj,
Kú ka një bres që s'ndrit veç me një burrë?
Kësáj i thonë Rom' e vënt ka mjaft,
Kur s'paska brënda veç një burrë vetëm.
Oh, ty dhe mua pleqtë na treguan
Që kish një herë një Jun Brut në Romë,
Që preferonte ferr-hobórr për jetë
Se sa një mbret mi kokë.

BRUTI.

S'dyshónj aspák që po më dó, or Kas;
Kú po më shtyn kështù, e marr pak vesh;
Q'i kam mejtuar dhe këtó dhe gjendjen
Do t' t'a tregónj mê vonë; po taní
S'më k'ënda, dhe të lutem miqësísht
Mê tutje mos më ngaj. Ató që the
Do t'i peshónj; ç'ke për të thën' akoma
Do t'i dëgjónj me nge dhe me durím
Dhe do tē gjejmë kohën e përtêshme
Këtó të larta gjëra t'i shoshitim.
Pra, gjer ahere, mbaj nër mënt këtê:
Qē Brutit i pëlqén mê mirë t'ishte
Një katundár se bir' i lart'i Romës
Nënë këtó kondita faqe-zeza,
Që gjendj' e sotme na ngarkón mi supet.

KASI.

Gëzohem që kjo gjuh' e pafuqishme
M'i nxori Brutit ca shkëndija zjarri.

BRUTI.

Mbaruan lodrat dhe Qesari kthehet.

KASI.

Kur të kalojnë, kap nga mënga Kaskën,
Dhe pas mënyrës tij' do t'na tregonjë
Çdo gjë me rëndësí që ngjau sot.

(*Hyjnë* QESARI dhe PASÔNJËSIT.)

BRUTI.

Ashtú vërtét po bënj. Po shih, or Kas,
Në ball' i ndrit Qesarit pik' e vrerit;
Të tjerët duken si ca qen të rrahur;
Fytyra e Kalfurnjës ësht' e zbetë,
Dhe syr'i Ciceronit zjarr i kuq,
Si shpesh në Kapitól e kemi parë
Kur na përfytej në Senát me shokët.

KASI.

Kaska taní po na tregón se ç'ngjau.

QESARI.

Antón!

ANTONI.

Qesár!

QESARI.

Rreth meje njerës le të kem të ngjallmë
Dhe kokë-rumbull dhe që flenë natën;
Ky Kasi atý ka sy të that' e t'urët;
Mejtohet tepër; pra, ësht'i rezikshim.

ANTONI.

Mos ia kij frikën; nuk ësht'i rezikshim.
Është Román bujár e burr'i urtë.

QESARI.

Më mirë t'ish m'i ngjallmë; s'ia kam frikën,
Po sikúr t'isha i zoti të kem frikë,
S'njoh asnjerí që duhet mbajtur lark.
Më tepër se ky Kas' i that' atý:
Këndón pa prerë, ësht' i math vërejtës
Dhe sheh përtéj çdo punë njérëzësh;
S'dó lodra, si dó ti, or Mark Antón;
S' dëgjón muzikë; rrallë buzë-qésh

Dhe buzë-qésh me një mënyrë, sikúr
Me veten tallet, sikúr qërtón shpirtin
Që mundi e buzë-qéshi me një gjë.
T' atijët s' rrinë kurrë zemër-qetë
Sa shohin tjatër më të math se veten,
Andáj pra janë shumë të rezikshim.
Të thom më tepër ç'duhet patur frikë
Se sa ç'kam frikë, se përherë jam Qesari.
Shko më të djathtë, se m' u-shúrth ky vesh
Dhe drejt më thuaj ç' idé ke për të.

(Marsh. Dalin QESARI dhe PASÔNJËSIT *veç* KASKËS.)

KASKA.

M'a hoqe mëngën; dó të flaç me mua?

BRUTI.

Pó, Kaskë, thúaj-më ç' ka ngjarë sot,
Që duket Jul Qesari aq' i mvrojtur?

KASKA.

Po ishe vet'atjé, apó nuk ishe?

BRUTI.

Po t'isha vetë, s'të pyesnja ç'ngjau.

KASKA.

Ja, i blatuan një kurorë; dhe kur ia blatuan, aý e vuri mënjanë me anën e prapme të dorës, kështú; dhe ahere, pópulli nisi të brohoritë.

BRUTI.

Po për ç'gië qé shamát' e dytë?

KASKA.

Ja, për këtê prapë.

KASI.

Brohoritnë tri herë; për gjë qé klithma e funtme?

KASKA.

Ja, për këtê prapë.

BRUTI.

A ia blatuan kurorën tri herë?

KASKA.

Pó, tamám, ashtú dhe aý e vuri mënjanë tri herë, çdo herë mê ëmbël se të parën; dhe çdo herë që e vente mënjanë, fqinjt' e mi zëmër-bardhë brohoritnin.

KASI.

Kúsh ia blatój kurorën?

KASKA.

Ja, Antoni.

BRUTI.

Tregóna-e me hollësitë, Kaskë.

KASKA.

Më vjen mê lehtë të varrem se sa t' ju tregónj hollësít' e ngjarjes, ish një komedí e fjeshtë; nuk e vura re mirë. Pashë Mark Antonin që ia blatój kurorën; po prapë s' qé tamám kurorë; ish një nga ató kurorkat; dhe sikundër ju thashë, aý e vuri mënjanë një herë; po me gjithë këtê, pas mëndjes sime, do t'a kish mbajtur mo gëzím. Ahere, ky ia blatój përsëri; ahere, aý e vuri mënjanë përsëri; po, pas mëndjes sime, s' i bënte zëmra fare t' i largonte gishtërinjtë prej saj. Dhe ahere, ky ia blatój për herën e tretë; aý e vuri për herën e tretë mënjanë; dhe çdo herë që e refuzonte aý, turma brohoritnin dhe trokitnin dúart' e krastítura, dhe hithnin përpjetë kësulat e dírsura, dhe çfrynin aqë shumë firomë kundërmónjëse që Qesari e refuzonte kurorën sa ment e mbytnë Qesarin; se i rá zalí dhe u-rrëzua për-dhé; dhe nga ana ime, s' kuxonja të qeshnja nga frika se mos hapnja gojën dhe më hynte në grykë er' e ligë.

KASI

Pó më thuaj, të lutem: sí! á i rá zalí Qesarit?

KASKA

U-rrëzua për-dhé në tribunë, dhe iu-shkumbëzua goja, dhe iu-líth gjuha.

BRUTI

Ishte fare e natýrëshme: se e zë ajó pun' e keqe.

KASI

Jo, Qesarin nuk e zë; po ty dhe mua dhe Kaskën trim na zë ajó pun' e keqe.

KASKA

S' di ç' dó të thuash me këtê, po jam shigúr, Qesari u-rrëzua për-dhé. Në qoftë se pópulli reckamán nuk e dorë-trokitnë dhe nuk e vërshëllyen, kur u pëlqente dhe kur u dëshpëlqente, sikundër bëjnë zakonërísht me aktorët në theatër, nukë jam burr' i vërtetë.

BRUTI

Ç' tha kur ardhi më vete?

KASKA

Ja, para se të rrëzohej, kur pá se kopeja komune ishte gëzuar që e refuzój kurorën, e çori dhe e hapi jelekun dhe i ftoj t' ia presin gërlanin. Dhe m' u-nxiftë shpirti, në mos kam dëshëruar t' a merrnja për fjale, pa le të shkonja në skëterrë me zuzarët. Dhe kështú u-rrëzua për-dhé. Kur ardhi më vete prapë, tha se, në qoftë se kish bërë a kish thënë ndonjê gjë pa vënt, u lutej zotërisë tyre të besonin që ia kish fajin sëmundja. Tri a katër femra, atjé ku qeshë, psherëtitnë: „ Ah, i várfëri! " dhe e ndjenë me gjithë zëmër; po kjo s' ka ndonjê rëndësí; se dhe sikúr t' ua kish vrarë nënat Qesari, prap' ashtú do të kishin bërë.

BRUTI

Dhe pas kësáj kalój kështú i mvrojtur?

KASKA

Pó.

KASI

A tha gjë Ciceroni?

KASKA

Pó, foli gërqísht.

KASI

E ç' desh të thoshte?

KASKA

S'di; para se t'jua them, do të më dalë shpirti. Po atá që e kuptuan buzë-qeshnë me njërjatrin dhe tuntnë kokën; po sa për mua, më ish gërqishte. Munt t' ju them dhe sa lajme të tjera: Marullit dhe Flavit ua mbyllë gojën nga shkaku që kishin hequr stolitë nga pikturat e Qesarit. Lamtumirë. Kishte dhe ca komedira të tjera akoma, po nuk i mbanj mënt.

KASI.

Tek un' á vjen për darkë sonte, Kaskë?

KASKA.

Jo, jam zotuar gjetkë.

KASI.

A vjen për drekë nesër?

KASKA

Me gas, në qofsha gjallë, e në qofsh shëndoshë, e në qoftë dreka jote e vyer për të ngrënë.

KASI.

Fort mirë; nesër pra, të pres.

KASKA.

Kështú: pra, lamtumirë që të dy. *(Del.)*

BRUTI.

Qýsh kaq' i trash' u-bê ky djalë?
Ish zjarr i mprehtë, kur në shkollë vente.

KASI.

Ashtú prap' është në të vepëruar
Çdo punë të guximtë dhe bujare,
Me gjithë që po duket i ngadalshim.
Kjo ashpërsí është si një lënk
I sqojtësisë, që t'a çel oreksin,
Të bën t' ia digjërósh mé mirë fjalët.

BRUTI.

Kështú tamám. Sa për 'taní, të lashë;
Dhe nesër, po të duash të fjalósemi,
Vinj në shtëpinë tënde; a në daç,
Tek unë eja ti, dhe do t' të pres.

KASI.

Vinj unë; gjer ahere, mejtó botën. *(Del* BRUTI.)
Më je bujár, ô Brut; po prapë shoh
Që zemr' e ndérçime munt të të kthehet
Nga udh'e vetes; duhet pra, përherë
Bujari pranë shokut të qëndronjë;
Se kúsh ësht'aq'i fortë sa s'gënjehet?
Qesari më urrén; po Brutn'e dó;
Të qeshë Bruti un'e aý Kasi,
S'kishte nevojë të më përkëdhelte.
Që këtê natë nga dritaret do t'i heth,
Me anë miqsh të ndryshmë, që t'i duken
Se ia dërgojnë disá qytetarë,
Ca shkresa që t'i çfaqin sá nderohet
Në Romë emr'i tij; atjé tërthori
Çkoqitet dhe ambicja e Qesarit.
Dhe pas kësáj, Qesari s'ka ku shkel;
Se do t'a tundim, a mê keq na del. *(Del.)*

SHKENÊ III

Gjithatjé. Një Rrugë.

Rrufé dhe vetëtimë. Hyjnë, nga anë të kúndërta, KASKA *me shpatën të çveshur dhe* CICERONI.

CICERONI.

Oh, mirë mbrëma, Kaskë! Thúaj-më
Qesarin á e shputë në shtëpí?
Psé t'u-zú fryma? Psé shikón ashtú?

KASKA.

Ti s'dó t'a dish, kur rrot'e tërë tokës
Po tundet si purtekë? O Cicerón!
Kam parë shqota, erëra të marra,
Që çajnë dushqe; dhe kam parë detin,
Që fryhet, shkumbëzohet e tërbohet,
Dhe gjer në re skërmítëse vërvitet,
Po kurrë gjer taní, gjer këtë natë,
Kurrë s'kam parë shqotë që çfryn zjarr.
A krisi luft' e brëndëshme në qjell,
A bota perëndít'i zemërój,
I ndezi sa na çojnë çkatërrimin.

CICERONI.

Vërtét, ç'gjë tjetër pé mê të çudiçme?

KASKA.

Një skllaf — e njeh nga pamja mirë — ngriti
Dorën e mëngjër lart, që digjej flagë,
Që ndritte sa njëzét pishtarë bashkë,
Po dora nuk iu-ngá aspák nga zjarri.
Pastáj — q'ahere shpatën e mbanj çveshur —
Nga Kapitoli pashë një luán
Që më shikój e tutje shkoj mërrzitur

Pa më cënuar; një qint gra të zbeta,
Të çmendura nga frika, ishin mbledhur
Në kodër, dhe betóhëshin që panë
Njerës të zjarrtë posht' e lart në rrugë.
Dhe die zogu i natës na qëndrój
Tamám në mes të ditës mun'mi forin
Dhe po vajtonte. Kur këtó çudira
Përpiqen bashkë, le të thonë bota:
„Ja shkaku i tyre; janë natyrale!"
Un'i besónj si shenja profetike
Mjerimesh nga një qjell i zemëruar.

CICERONI.

Vërtét, sot gjendja është lesh e li;
Po dhe njeriu gjërat i shpjegón
Pas qefit, fare lark kuptimit tyre.
A vjen në Kapitól Qesari nesër?

KASKA.

Pó, vjen; se porositi Mark Antonin
T'ju lajmërojnë që na vjen atjé.

CICERONI.

Natên e mirë pra, ô Kaskë; sonte
Me këtê qjell të trubull s'ecet rrugës.
(Del CICERONI. *Hyn* KASI.)

KASI.

Kúsh është?

KASKA.

Një Román.

KASI.

Kaska, pas zërit.

KASKA.

Ke vesh të mirë. Kas, ç'nat' është kjo!

KASI.

Një nat'e mirë për të ndérçimit.

KASKA.

Kúsh pá një qjell kaqë skërrmitës?

KASI.

Atá q' e panë dhenë plot me faje.
Se sa për mua, kam baritur rrúgëve
Dhe kokën ia kam unjur natës s' ashpër,
Dhe ja kështú, si po më sheh, ô Kaskë,
Rrufesë ia kam hapur krahërorin;
Dhe kur shigjeta vetëtimash çirnin
Zëmrën e qjellit, veten paraqitnja
Atjé ku shkrepëtinin e qëllonin.

KASKA.

Po psé kështu e provokove qjellin?
Njeriu trëmbet, dridhet doemós,
Kur perëndit' e lart na habitin
Me shenja dhe kasnecë të tmerruar.

KASI.

Më je i fjetur, Kaskë, dhe shkëndijat
E jetës që ka një Román s'm'i ke,
A s' i përdór. U-zbeve, hape sytë,
U-trëmbe, u-tmerrove, u-trullose,
Kur sheh mërín'e qjejve të çkallmuar;
Po shkakun e vërtetë në kërkófsh,
Psé këtó zjarre, psé këtó fantazma,
Psé shpënda e shtaza çthuren, çfisërohen,
Psé pleq e çilimínj profetësojnë,
Psé që të gjitha ndrrojnë régulla,
Natyrë dhe zakone të mëparshme
Në cilësira monstruoze, ahere
Zbulón që qjelli i fryméjj kështú,

I bëri vegla frike e lajmërimi
Përmí një gjendje monstruoze.
Taní á munt të të tregónj një burrë,
Tamám si nat' e sotme e tmeruar
Që bumbullín e vetëtín, hap varret
E ulërín, luán në Kapitól,
Jo më të fortë se sa ti dhe unë
Nga trupi, po q'u-rrít si një kuçedër
E na tmerrón si këtó krisma t'egra.

KASKA.

Flet për Qesarin; apó jo, or Kas?

KASI.

Kush dashtë qoftë; se taní Romanët
Na paskan vetëm trupet si stërgjyshët,
Po frym'e átërve na paska vdekur
Dhe shpirt'i nënave na qeveriska;
Se zgjedha që durojmë na çfaq gra.

KASKA.

Vërtét, thuhet se nesër senatorët
Mejtohen t'a vëndosin mbret Qesarin
Me një kurorë përmí tok'e det,
Kudó përjashta Italisë.

KASI.

Ahere kamën di kú t'a vendós:
Nga robëria Kasi çlirón Kasin.
Kështú, ô qjell, e bën të dóbëtin të fortë
Kështú, ô qjell, tiranët i përmbýs:
Sepsé as kulla as muri qipre
As burgje t'errët as zinxhire hékuri
Nuk e përmbajnë dot fuqín'e shpirtit;
Po jetës lodhur nga këtó pengime
S'i mungón kurrë forc' e vetë-shojtjes.

Kur di këtê, e dittë bot'e tërë
Që pjesën tiranie që durónj
E shkunt kur të më teket.

KASKA.

Dhe unë gjithashtú:
Kështú çdo skllaf e mban në dorë
Fuqinë t'a mbaronjë skllavërín'e tij.

KASI.

Dhe psé Qesari na u-bë tirán?
I shkreti! Jam shigúr që s' bëhej ujk
Veç nga që pá se qenkan dhën Romanët;
S'bëhej luán pa qënë dhi Romanët;
Atá që duan shpejt të ndezin zjarr
Me kasht'e nisin; ç'gatër qënka Roma,
Ç' bluáshk' e ç' plehë që shërbén të ndritë
Një gjë të poshtër aqë sa Qesari?
Po, ah! ô helm i zëmrës, kú më shpure?
Se nofta flas përpara një shpirt-skllavi;
Ahere di sí të përgjigjem: Jam
I armatisur dhe s' më trëmp reziku.

KASKA.

Kaskës i flet, e një njeriu, i cili
S' të di pallavra. Ja ku t'a jap dorën;
Formó partí të ndreqsh këtó mjerime
Dhe këmbën do t'a shpie aqë lark
Sa s'ka më tej.

KASI.

U-mbýll pra pazarllëku.
Mësó ahere, Kaskë, që kam bindur
Disá nga më të ndérçimit Romanë
T'i víhemi një pune të përbashkme,
Të ndérçime dhe të rezikshime.

Dhe di se në Portikën e Pompeut
Më presin shokët; se me këtê natë
S' barét e s' pipëtín njerí në rrugët,
Dhe ngjyr'e eleméntave na është,
Si në favór të veprës që gatitim,
E gjakt'e zjarrt'e krejt e tmérrshime.

KASKA.

Rri pranë, se dikúsh vjen me nxitím.

KASI.

Na qënka Cinna; po e njoh nga ecja.
E kemi mik. (Hyn CINNA.) Kú po shpejtón, or Cinnë?

CINNA

Te ti. Kush është ky? Mos është Cimbra?

KASI

Jo, është Kaska, shok në pllanin tonë.
Po á më presin shokët, Cinnë?

CINNA

Gëzohem. Ç'nat' e tmerrshme është kjo!
Nja dy a tre prej nesh na kanë parë
Ca pamje të çudíçime.

KASI

Më thuaj á më presin?

CINNA

Pó, të presin.
O Kas, sikúr të muntnje të fitonje
Bujarin Brut për shoqërinë tonë —

KASI

Fli mendjen. Cinnë, merr-e këtê kartë

Dhe vër-e përmí fronin e pretorit,
Ku munt t' a gjenjë Bruti; këtê hidhj' a
Përmés dritares; vër këtê me vulë
Përmí statujën e Jun Brutit vjetër;
Si t' i mbarósh këtó, u-kthe me vrap,
E gje-na në Portikën e Pompeut,
A jan' atjé Dec Bruti dhe Treboni?

CINNA

Të gjithë përvéç Cimbres: se ky shkoj
Të të kërkonjë në shtëpí. Pra, unë
Shkonj, vë pas porosisë sate kartat.

KASI

Dhe ktheh-u në Theatrin e Pompeut. *(Del CINNA.)*
Haj, shkojmë, Kaskë; unë që me-natë
Shoh Brutin në shtëpí të tij: tri pjesa
Ia kemi tonat dhe me këtê pjekje
Të tërë do t'a kemi të fituar.

KASKA.

Oh, në çdo zëmër ka një nder të lartë:
Dhe punën, që nga né del si një krimë,
Me namin, si me alkemí të pasur,
E ndrron aý në vler' e në virtyt.

KASI

E ke kuptuar fare mir' atê,
Vlerën që ka, nevojën që ia kemi.
Hajde, se shkoj mes-nata; dhe pa gdhirë
Duhet t'a sqojmë dhe t' a shigurojmë.

(Dalin.)

AKT II

SHKENË I

Romë. Kopshti i Brutit.

Hyn BRUTI.

BRUTI.

Eh, Luc! Kú je?
Nga yjtë s' marr dot vesh sá orë duhen
Gjer sa të gdhihet. Luc, or djalë!
Sá dëshërónj t' a kisha këtë cen,
Të flinja rëndë! Zgjoh-u, Luc! or Luc! *(Hyn* LUCI.)

LUCI.

Më thirre, Imzót?

BRUTI.

Shpjer një qirí në dhomën time, Luc;
Dhe si t' a ndezësh, eja këtú, më thirr.

LUCI.

Si urdhërón, Imzót. *(Del.)*

BRUTI.

I duhet vdekja; dhe nga ana ime,
S' kam shkak privát po të përgjithëshmi
Që t' a godít. E dëshërón kurorën;
Natyrën qýsh ia ndrron kjo gjë, ja çështja:
Se dit' e ngrohtë na e rrit nëpërkën,
Dhe duhet të baresim me kujdés.

T'i falim një kurorë? Pikërisht:
Kështú pa fjalë vet' i japim thumbin,
Që kur t' i teket, munt të na kafshonjë.
Çpërdórj' e madhërisë vjen, kur ndahet
Ndërgjégjia nga fuqia; dhe, të them
Të drejtën për Qesarin, nukë di
Kúr pasionet po e zotërojnë
Më tepër se sa arësýj' e tij.
Po ësht e dítur prej të gjithëve
Q' ambícj' e re përúnjien e ka shkallë
Dhe ngjítësi përpjét' e kthen fytyrën;
Po me t'arrirë mun' në majë fare,
Ia kthen ahere shkallës shpátullat,
Në retë sheh, përbúz të poshtmet grada
Ngá u-ngjít lart. Kështu Qesari nofta:
Pra, ndal-e, mos e bënjë. Dhe kur sherri
S' ka ngjyr' e shkak nga ç' është sot Qesari,
E shtró kështu; n' u-rrittë më se ç'është
Arrín këtó, ató ekstremitete;
Pra, qúaj-e si vezë gjárpëri,
Që n' u-klloçittë, lint me helm pas farës,
Dhe vraj-e mun' në ciflë. *(Hyn përsëri* LUCI.)

LUCI.

Qirín' e ndeza n' odën tënde, Imzót.
Gur zjarri kur kërkonja në dritare,
Kam gjetur këtê kartë tê vulosur.
Pa fjalë s' qé atjé kur shkova e fjeta.

BRUTI.

Shko prap' e fli; se s' është gdhirë édhe.
Mos kemi nesër, bir, idat e Marsit?

LUCI.

S' e di, Imzót.

BRUTI.

Shikó në kalendarin dhe më thuaj.

LUCI.

Si urdhërón, Imzót.

BRUTI.

Nga vetëtimat që po çajnë erën
Kam dritë mjaft sa t'a këndónj. *(E çel letrën.)*
„O Brut, po fle; pa zgjoh-u dhe shih veten!
A rron dot Roma...? Fol, qodít, rindréq!
O Brut, po fle; pa zgjoh-u!"
„A rron dot Roma...?" Vet' e plotësónj:
A rron dot Roma nënë tmerr tirani?
Sí, Roma: Një stërgjyshi im nga rrugët
Ia zboj Tarkinin, kur u-qúajt mbret.
„Oh, fol, godít, rindréq!" Me luten
Të flas e të godít? Betohem, Romë,
Në qoftë se rindréqja sakt pasón,
Kërkesën dor' e Brutit t'a mbarón! *(Hyn përsëri* LUCI.)

LUCI.

Zot, Marsi mbush katërmbëdhjetë ditë.
(Trokitje përbrënda.)

BRUTI.

Fort mirë; shko, dikúsh trokét në derë. *(Del* LUCI.)
Që-kúr me çpoj kundër Qesarit Kasi
S' kam fjetur.
Që nga lëvízj' e par' e sa t' arrijmë
Te vepërimi i një pune tmerri
Koha në mest na duket si fantazmë,
A ëndërr e shëmtuar; kryemëndja
Dhe veglat vdékëse mbajnë këshillë;
Dhe gjendja e njeriut ësht' ahere
Si nonjë mbretërí e vogël që kalón
Një farë kryengritje. *(Hyn përsëri* LUCI.)

LUCI.

Zot, është Kasi, yt-kunát, në derë,
Që dëshërón të të shikonjë.

BRUTI.

A ësht' i vetëm?

LUCI.

Jo, Zot; ka pás disá të tjerë.

BRUTI.

A i ke njohur?

LUCI.

Jo, Zot; i kanë shapkat përmí sy
Dhe gjysmën e fytyrës nënë gunë,
Dhe s' ishte punë që t' i njihnja dot
Nga nonjë vij' e faqes.

BRUTI.

Le të hyjnë. *(Del* LUCI.)
Janë partia. Konspiratë, natën
Ke turp të çfaqësh ballin e dyshimtë,
Kur ësht' e lir' e liga. Oh, po ditën
Kú do të gjësh një shpellë t' errët mjaft
Të kllaç fytyrën tënde monstruoze?
Oh, mos kërkó asnjë, ô konspiratë.
E fshih me buzë-qéshj' e ëmbëlsí;
Se sikur të baréç me faqen natyrale,
As vet' Erebi s' ësht' i ngrysur mjaft
Sa të të mpronjë nga zbulimi.

(Hyjnë Konspiratorët, KASI, KASKA, DECI, CINNA, METÉLL CIMBRA *dhe* TREBONI.)

KASI.

Më duket, kemi ardhur tepër shpejt.
Mirë mëngjés! A po t' a prishim prëhjen?

BRUTI.

I ngritur, isha, s'fjeta tërë natën.
Po shokët që ke pás i njoh a jo?

KASI.

Pó, cilindó prej syresh; cilidó
Po të nderón; dhe cilidó urón
Të kesh për veten tënde atê mëndje
Që të ka çdo Román bujár në botë.
Ky është Treboni.

BRUTI.

Mir' se na ardhi.

KASI.

Dhe ky Dec Bruti.

BRUTI.

Mir' se na ardhi dhe aý.

KASI.

Ky Kaska; e ky Cinna; e ky Cimbra.

BRUTI.

Mir' se na arthtë që të gjithë.
Ç' kujdese vigjëllónjëse u-vunë
Në mes të natës e të syve tuaj?

KASI.

Të lutem, të të them një fjalë.
(BRUTI *dhe* KASI *pështpëritin.*)

DECI.

Këtejza gdhihet dita, apó jo?

KASKA.

Jo.

CINNA.

Pó, dhe ató vija zbárdhëse,
Që çajnë retë, lajmërojnë ditën.

KASKA.

Më ndjeni, që të dy lajthíteni.
Këtéj, ngá drejtónj shpatën, me del díelli,
Dhe tepër na rëndón nga an' e jugës
Pas stinës motit ku po ndódhemi.
Dy muaj pás, më lart e nga veriu
Na çfaq më parë zjarrin; lindj' e lartë
Qëndrón nga Kapitoli, drejt atý.

BRUTI.

Më jipni dorën që të gjithë, ô shokë.

KASI.

Dhe për vëndimin të betóhemi.

BRUTI.

Jo, jo, s' ka bé; në qofshin faqe burrash
Dhe vojtje shpirti dhe çkallmés' e kohës
Shkake pa forcë, ndáhuni në çast
Dhe shtríhuni në shtrat përtác e flini;
Le të vazhdonjë tirania shtýpëse
Gjer sa të bini një nga një me radhë.
Po si besónj, në patshin këtó zjarr
Të mjaftë sa të ndezin burracakë
E sa të trimërojnë gra shpirt-shkrira
Ç' nevojë kemi ahere, qytetarë,
Për tjatër çpojtje përvéç çështjes sonë
Si shtyrje për rindréqien? Ç' lidhje tjatër

Veç që Romanë fshehtas dhanë fjalën
Dhe s' kthehen prapë kurrë? Ç' tjatër bé
Përvéç që nderi u-líth përpara nderit
Që a e bëjm' a vdesim për këtê?
Betohen priftërínj, frikaçë dhe zuzarë,
Pleq trup-kufoma, skllevë frymë-ngordhur,
Që mirë-presin çdo padrejtësí;
Për çështje të dyshimtë bëjnë bé
Për shtrêmbërit. Pra le të mos i ndyjmë
Virtýtn' e rëndësín' e pllanit tonë
As frymat prej metali të pathýera,
Dyke mejtuar që kjo çështj' e vepër
Kërkón një bé; sepsé çdo pikë gjak
Që ka në zemër çdo Román bujár
Mban kúsh e di sá vula doçërie,
Në shkeltë makár pjesën mê të vogël
Të nji zotimi q' i ka dhënë goja.

KASI.

Po Ciceronin? A do t'a sondojmë?
Besónj, do t'na përkrahë shumë fortë.

KASKA.

S' duhet t'a lëmë jashtë.

CINNA.

Jo me asnjê mënyrë.

METELLI.

Le t'a fitojmë. Thinjësí' e tij
Na ble për veprën një mejtím
Dhe një levdatë prej shumice zërash;
Se do të thuhet që gjykím' i tij
Na ka drejtuar dúartë; risia
Dhe nxehtësia jonë s' duken fare,
Se rëndësí' e tij na i mbulón.

BRUTI.

Mos m'a kujtoni; mos t'i hápemi;
Se kurrë nukë vete pas një pune
Q' e nis një tjatër.

KASI.

E lëmë jashtë pra.

KASKA.

Vërtét, s' na bën.

DECI.

Tjatër njerí s' po ngasim veç Qesarit?

KASI.

Dec, mir' e hape. Unë thom se s' bën
Q' Antoni, mik i ngusht' i Jul. Qesarit,
Të lihet gjallë. Se n' i mirësoftë
E n' i zgjeroftë mjetet, na sjell kokën rrotull.
Për të ndaluar pra këtê rezík,
Antoni dhe Qesari le të bien bashkë.

BRUTI.

Tepër gjak-derdhës dúkemi, Kaj Kas,
Kur passí presim kokën, grijmë miset
Nga zëmërimi e cmiri për kufomën.
Antoni është mis i Jul Qesarit;
Dhe jemi meshëtár' e jo kasapë.
Qëndrojmë kundër frymës së Qesarit;
Dhe frym' e njérësve s' ka gjak asfare.
Sikúr të muntnim t' i goditnim frymën
Pa ia cënuar trupin! Po mjerísht,
Qesari duhet të përgjaket. Pra,
T' a vrasim me kuxím, po pa mërí;
T' a presim si një gjellë perëndísh
E jo t' a çjerim si kufomë qenash;
Dhe zëmra jonë, si një zot i hollë,
T' i shtynjë trimat për një vepër t' ashpër
Dhe t' i qërtonjë pás. Kështú e çpallim

Punën të domosdoshme, jo t' urryer;
Kështú pra çfáqemi në sy të botës
Dhe qúhemi spastronjës e jo vrasës.
Mos u-mejtoni pra për Mark Antonin.
Si krah' i Jul Qesarit s' prish dot punë,
Passí t'ia presim kokën Jul Qesarit.

KASI.

Po unë prapë ia kam frikën:
Se është mik me zëmër i Qesarit —

BRUTI.

I dashur Kas, mos e mejtó aspák:
N' e dó Qesarin, s' ka se ç' bën përveç
Të vriteť e të vdesë për Qesarin;
Dhe gjer atjé s' arrín; se ësht' i dhënë
Pas qefit, pirjes, dárkave me shokë.

TREBONI.

S' ësht' i rezikshim; nuk e vrasim pra;
Dhe rron e për këtê pastáj qesh vetë. *(Trokét sahati.)*

BRUTI.

Pushoni! Nëmëroni orët.

KASI.

Ësht' ora tri.

TREBONI.

Kohë të ndahemi.

KASI.

Po s' dim' á del Qesari sot a jo;
Se është bërë superstíciós,
Kur mê përpara s' i peshonte fare
Ceremonitë, fantasít' e ëndrrat.
Nofta pra shenjat e çudíçime
Dhe tmerr' i pazakónt' i kësáj nate,

Si dhe kēshillat e falltárëve,
T'a mbajnë lark prej Kapitolit sot.

DECI.

Mos kini frikë; se në dalt' ashtú,
Mëndjen ia kthenj; se i pëlqén t' i thonë
Që rinokerin munt t' a kapë lisi,
Pasqyra arinë, trapi elefantin,
Rjeta luanin, lájkësi njerinë;
Dhe kur i thom që lajkën e urrén,
Po, thotë, e lajkēsohet ca më tëpër.
I vihem punës pra.
Se ngá të dua munt t'ia prier tragën
Dhe deomós e sjell në Kapitól.

KASI.

Pó, vijmë që tē gjithë t'a përcjellim.

BRUTI.

Më ora tetë; s'bën më von; a jo?

CINNA.

Jo, s' bën më von; pra, éjani pa fjalë.

METELLI.

Ligari nuk e dó aspák Qesarin,
Se iu-skērrmít për fjalën mi Pompeun;
Çudí sí s' e kujtój asnjë prej jush.

BRUTI.

Metéll i dashur, shko dhe gjej-e shpejt;
Më dó, dhe për këtê ká arësye;
M' a ço këtú dhe di sí t' a fitónj.

KASI.

U-gdhí; të shkojmë pra, i dashur Brut,
Dhe ju, ô miq, përndáhuni taní,

Kujtoni që të gjithë ç' kini thënë,
Tregóhuni Romanë të vërtetë.

BRUTI.

Miq, dúkuni të çkafët, buzë-qeshur;
Qëllimin mos e çpallim përmi ballë,
Po si aktorët tanë le t' a mbajmë
Me gjallësí, qëndrés' e rëndësí;
U-gdhifshi pra shëndoshë, miq e shokë.

(Dalin të gjithë veç BRUTIT.)

Or djalë! Luc! Fle prapë? Po s' ka gjë.
Gëzó-e gjumën-vés' e mjaltë-rëndë;
S' ke fantasirat as figurat
Që kllet në tru të njérësve kujdesi,
Dhe përandáj fle rëndë. *(Hyn* PORSHA.)

PORSHA.

Brut, Imzót!

BRUTI.

Ç' më pate, Porshë?Kaqë shpejt ç' m' u-ngrite?
S' t'a ngre shëndeti as trup' i pafuqishmë
Të dalësh me këtê mëngjés të ftoftë.

PORSHA.

As ty s' t' a, dó. I zëmëruar, Brut,
Nga shtrati m' ike; dhe nga darka prëmë
U-ngrite béfas, dhe barisnje rrotull
I mvrojtur, psherëtitës, krahë-krýq;
Kur të pyeta ç' kishe, më shikove
Me sy të ngrysur; prap' e mê t' u-luta;
Ahere krove kokën pa durim,
Për-dhé përpoqe këmbët i mërrzitur;
Prap' insistova, prapë s' m' u-përgjigje,

Po më lëvizje dore t'inatosur
Më bëre shenjë të largohem. Shkova
Nga frika mos t' a ndisnja zëmërimin
Që të 'kish ndezur tepër dhe me shpresën
Që s' ish veç një çdëfrím i qefit prishur,
Që disá herë njerí e ka.
Po ja taní as há as flet as fle
Dhe sikúr pamja të të ndrrohet aqë
Sa t' është trubulluar dispozita
S' të njoh dot mê, ô Brut. Imzót i dashur,
Tregóm'a ç'është shkaku i helmit tënt.

BRUTI.

S' jam mirë nga shëndeti, s'kam gjë tjatër.

PORSHA.

Sikundër je i mënçur, t'ish sëmundje,
I gjenje mjetet që t'a kapërcenjë.

BRUTI.

Atê po bënj. E dashur, shko e fli.

PORSHA.

Sëmurë qënke! po á më shërohesh,
Kur çveshur më barét e më thëthín
Notín' e lagësirës mëngjezore?
Sí! Qënke i sëmurë dhe largohesh
Nga shtrati i shëndetshëm dhe përbáll
Lëngatat e pabesa që ngjit nata,
Të ftohesh ethe me pahir të kapsh,
E të sëmuresh ca mê keq? Jo, Brut,
Diç ke në shpirt lëngát' e vrer,
Q' e drejta, digniteti i pozitës
M' a dó t'a di; dhe ja, mëgjúnjazi
Të lutem fort, për atê bukurí
Me nam që pata, për ató betime
Të dashurisë sate, për kurorën
Që na bashkój, na lidhi si një trup,

T' i çfaqesh vetes sate, gjysmës sate,
Psé je i mvrerët, ç' njerës qén atá
Që t' ardhë sonte; se këtú t' u-mblodhë
Nga gjasht' a shtatë dhe fytyrën fshehnin
Edhé nga errësira vetë.

BRUTI.

Më gjunjë mos më bjer, e ëmbel Porshë.

PORSHA.

S' kisha përsé, po t' ish m' i ëmbël Bruti.
Me lidhjen e marrtesës, Brut, më thuaj
Mos jam e përjashtuar nga sekretet
E tua të veçanta? Vetja jote
Mos qënkam me kufí, sidó-kudó,
Të há me ty e shtratin të t' a shtronj
E të të flas her-herë? Në mos më,
S' jam jote-shoqe, qënkam jote-dashur.

BRUTI.

Je ime-shoq' e ndérçime, besnike,
E dashur sa dhe gjaku i kuq që kam
Në zëmrën e helmuar.

PORSHA.

Në qoft' ashtú duhet t'a di sekretin.
Vërtét jam grua, po nga ana tjatër,
Kam burrë Brutin, qe më zgjodhi shoqe;
Vërtét jam grua, po nga ana tjatër,
Grua me nder, e bija e Katonit.
Besón, m' e fortë s' jam nga seksi im
Me át' e burrë si aý e ti?
Çfaqm'a sekretin, se s' do t' a përháp.
Kam dhënë provë force dhe qëndrese,
Këtú, kur kofshën vet' e kam plagosur;
Sí e përmbajta me durím këtê,
Dhe s' fshehkam dot sekretet e tim-shoqi?

BRUTI.

O perëndira! Bëmëni të vlenj
Këtë bujare shoqe. Pa dëgjó!
Dikúsh trokét; e dashur, shko pak brënda;
Dhe shpejt ka për të pritur gjiri yt
Nga zëmra ime çdo sekrét;
Do t' t'a çkoqít çdo lidhje që kam bërë
Dhe tërë kryevijën e fytyrës mvrojtur.
Largóh-u me nxitim. (*Del* PORSHA. *Hyn* LUCI.)
Luc, kúsh trokiti?

LUCI

Këtú një i sëmurë dó me ty të flasë. (*Hyn* LIGARI.)

BRUTI.

Ligari, per të cilin foli Cimbra.
Largóh-u, djalë. Kaj Ligár, mirsardhe!

LIGARI.

Të falem me një gjuhë të sëmurë.

BRUTI.

Ah, ç' kohë gjete për shamí, trim Kaj!
Sá desha të mos m' ishe i sëmurë!

LIGARI.

S' jam i sëmurë, po të kesh një punë
Që meritón një emër nderi.

BRUTI.

Një gjë t' atillë kam nër mënt, Ligar,
Vesh të shëndoshë t'a dëgjósh në patsh.

LIGARI

Për përënditë, që Romanët lusin,
Ja, tej e heth sëmundjen. Shpirt i Romës!

Bir trim, i lindur nga oxhák bujár!
Si eksorkíst i shenjtë, ti m' a zgjove
Frymën e vdekur. Thúaj-më të rent
Dhe do të sulem kundër së pamúndurës
Dhe dolla faqe-bardhë. Ç' duhet bërë pra?

BRUTI.

Një punë q' ësht iláç për të sëmurët.

LIGARI.

Mos është vrer për disá të shëndoshë?

BRUTI.

Tamám! Dhe ç 'farë punë është kjo,
Dhe kujt i duhet bërë, t' a shpjegónj
Kur shkojmë tek aý q' i duhet bërë.

LIGARI.

Përpara pra; dhe unë pás të vinj
Me zëmër të rindezur të bënj diç
Që s' di; mjaftón që Bruti m' udhë-héq.

BRUTI.

Pra, bjer-më pás. *(Dalin.)*

SHKENË II

Gjithatjé. Shtëpí' e Qesarit.
Bumbullima dhe vetëtima. Hyn QESARI me rrobën e natës.

QESARI

As qjelli as dheu s' patnë paqë sonte;
Kalfurnja thirri nja tri herë n' ëndërr:
„Ndihmoni, oh! Po vrasin Jul Qesarin!"
Kúsh është atý? (*Hyn një* SHËRBËTOR.)

SHËRBËTORI.

Imzót!

QESARI.

Shko shpejt e porosít-i priftërinjtë
Të bëjnë sakrifice e lajmëró-më
Ç' mejtime kanë për suksesin tonë.

SHËRBËTORI.

Si urdhërón, Imzót. (*Del. Hyn* KALFURNJA.)

KALFURNJA

Ç' po bën, Qesár? Mejtón të dalësh jashtë?
Sot s' duhet të lëvizësh nga shtëpia.

QESARI.

Pó, dal; asgjë s' më kërcënón përvéç
Prapa kurrizit; se posá shikón
Fytyrën e Qesarit, çduket béfas.

KALFURNJA.

Qesár, në shenja s' kam besuar kurrë,
Po sot më trëmbin. Dikúsh atjé brënda,
Veç gjêrave që pamë dhe dëgjuam,
Tregón dhe ca të tjera pamje tmerri:
Një luaneshë ulëriti mb' udhë;
Varret u-hápn' e dúallë të vdékurit;
Mi re lëftuan zjarr-ushtarë t' egër,
Me legjiona dhe shtrumenta lufte
Dhe gjak mi Kapitolin ka pikuar;
Buj' e betejës oshëtinte n' erë,
Të ndezur hingëllinin kúajtë,
Fantazmat rrúgëve këlthisnin!
Qesár, këtó s' na janë parë kurrë,
Dhe un' ua kam frikën.

QESARI.

Qýsh mundim të shpëtojmë nga ató
Që perënditë vunë për qëllím?
Dal pra; se këtó shenja s' janë vetëm
Për mua, po edhé për tërë botën.

KALFURNJA.

Kur vdes një liparák, s' del një komét,
Po ndizen qjejtë kur na vdesin princët.

QESARI.

Frikaçi vdes përpara vdekjes shpesh;
Po trimi kurrë s'vdes veç se një herë.
Besónj, m' e madhja prej çudive është
Që njérëzit ia kanë frikën vdekjes,
Kur dinë q' është fund' i domosdoshmë
Dhe do t' na vinjë kur na ka për t' ardhur.
(Hyn përsëri SHËRBËTORI.) Ç' po thon' augurët?

SHËRBËTORI.

Të këshillojnë të mos dalësh sot.
Kur nxúarë mëlçít' e sakrificit,
Zëmrën s' ia gjetnë dot në krahërór. *(Del).*

QESARI.

Këtê e bëjnë perëndit' e lartë
Sa për tê turpëruar burracakët;
Do t' isha bagëtí pa zëmër fare
Në ndënjça sot nga frika në shtëpí.
Jo, s' rri; reziku e di fare mirë
Që jam mê i rezikshim se aý:
Jemi luanë, lindur më një ditë,
Dhe unë jam i pari e m' i tmerrshmi.
Pra, Jul Qesari del.

KALFURNJA

Ajmé, Imzót,
Besimi t' a ka mbytur urtësinë.
Mos dil sot; thuaj se nga frika unë
Të mbajta në shtëpí pa dashjen tënde.
Dërgojmë Mark Antonin në Senát
T' u thotë që s' je mirë nga shëndeti.
Mëgjúnjazi të lutem, bëj si thashë.

QESARI.

Antoni do të thotë që s' jam mirë
Dhe sa për qefin tënt rri në shtëpí. *(Hyn DECI).*
Ja, Deci munt të vejë t' ua thotë.

DECI

Të falem, ô Qesár. Mirë mëngjés.
Po vinj të të përcjéll gjer në Senát.

QESARI.

Dhe vjen tamám në kohë që t' u shpiesh
Të fala senatórëve e t' u thuash
Që s' vinj sot; ësht' e rreme që s' e bënj dot,
Dhe ca m' e rreme që s' kuxónj t' a bënj;
S' vinj sot; kështú u thuaj pra, ô Dec.

DECI

Qesár i lartë, më tregó një shkak
Që të mos qeshem kur t' u them ashtú.

QESARI.

Një shkak? Se ashtú dua; nukë vinj;
Ja mjaft për të kënaqur senatorët,
Po për kënáqien tënde të veçantë,
Nga që të dua, ja ku t' a tregónj:
Kalfurnja, ime-shoqe, më ndalón;
Pá n'ëdërr sonte që statuja ime,
Si shadërván i math me një qint sope,
Ka derdhur gjak; dhe turma prej Romanësh
Me buzë-qeshje vinin, lanin dúartë;
Dhe e shpjegón si parëlajmërím
Mjerimesh që më varren përmí kokë;
Dhe përandáj m' u-lút mëgjúnjazi
Të mos largohem nga shtëpia sot.

DECI.

Kjo ëndërr u-shpjegua fare shtrëmbër,
Se është lajm' e bukur dhe fat-bardhë:
Statuja gjak-vërvítëse me qyngje
Ku láhëshin Romanët buzë-qeshur
Tregón që Rom' e madhe po thëthín
Prej teje pirje jete për rilindje,
Dhe njerës të mëdhénj t'afrohen rrotull
Për ngjyr' e myr' e shenj' e hajmalí.
Këtë kuptím ka ëndërr' e Kalfurnjës.

QESARI

Dhe na e ke shpjeguar fare mirë.

DECI

Vërtét, dhe më dëgjoni ç'kam të them:
Mësoni se Senati ka vëndosur
Të të blatonjë një kurorë sot.
N'u thënç që s'vjen, nofta e ndrrojnë mëndjen.
Pastáj, si tallje nofta do t'u duket,
Dhe dikúsh munt të ngrihet e të thotë
T'a lëmë mbledhjen për një ditë tjatër,
Kur të na shohë ëndrra më të mbara
E shóqia e Qesarit; dhe n'u-fshehç,
Ahere vall'á nukë pëshpëritin:
„Shikó! Qesari paska frikë?"
Më ndje, Qesar, se dashuria ime
Kështú të t'a gjykónj më thotë sjelljen,
Dhe arësyja ime e përkráh.

QESARI.

Taní, sá e paarësyshme duket
E tërë frika jote, moj Kalfurnjë!
Dhe më vjen turp që të jam bindur.

Nem rrobën se po shkonj.

Hyjnë PUBLI, LIGARI, METELLI, KASKA, TREBONI *dhe* CINNA.)

Ja edhé Publi vjen, të më përcjellë.

PUBLI.

Mirë mëngjés, Qesar.

QESARÍ

Mirsardhe, Pubël.
Sí, Brut? Je ngritur kaqë shpejt dhe ti?
Mirë mëngjes, or Kaskë! Kaj Ligár,
Qesarin s'e ke patur aq' armík
Sa ethet që kështú të paskan ligur.
Sá është ora?

BRUTI

Qesar, trokiti ora tetë.

QESARI.

Ju falem nderit shumë për mundimin
Dhe për fisnikërinë tuaj. Shihni.
Antoni që bën qefe tërë natën
Prap' është ngritur. Mark Antón, mirsardhe!

ANTONI.

Mirë mëngjes, Qesár i lartë.

QESARI.

U thoni të gatiten atjé brënda.
Më ndjeni që ju bëra të më prisni.
Aj Cinnë; aj Metéll; dhe ti, Trebón!
Kam nonjë orë muhabét për ty;
Kujtó-e pra, dhe eja sot tek unë
Dhe rri-më pranë që të të kujtónj.

TREBONI.

Si urdhërón, Qesar. *(Mënjanë.)* Dhe aqë pranë
Sa miqt' e tu do t'deshnin t'isha lark.

QESARI.

Miq, eni t'ju gostít me pakëz verë.
Pastáj, si miq, të gjithë shkojmë bashkë.

BRUTI.

(Mënjanë.) Që dukjet s' janë një hesáp, Qesár,
Gjak zëmra më pikón, kur e mejtónj. *(Dalin.)*

SHKENË III

Një Rrugë pranë Kapitolit.

Hyn ARTEMIDORI, *dyke kënduar një kartë.*

ARTEMIDORI

Qesár, rúaj-u nga Bruti; kij mëndjen nga Kasi; mos iu-afró Kaskës; kij'a syrin Cinës; mos i kij besím Trebonit; vër-e re mirë Metéll Cimbrën; Dec Bruti nukë të dó; e ke çartur Kaj Ligarin. Të gjithë këtá njerës s'kanë veç se një mëndje, dhe kjo është kundër Qesarit. Në mos qofsh i pavdekshim, hith syrin, rreth teje; çkujdesja ia çel udhën konspiratës. Perëndít' e lartë të mprofshin. Miku yt, ARTEMIDORI.

Këtú qëndrónj gjer sa kalón Qesari
Dhe si kërkonjës po ia jap këtë.
Zëmra më qan që s'mprohet dot virtyti
Nga dhëmbët e nakarit.
Në m' a këndófsh këtë, Qesár, na rron;
Në mos, po Fati tradhëtorët mpron. *(Del.)*

SHKENË IV

Gjithatjé. Një Pjesë tjatër e gjithasáj Rruge, përpara Shtëpís' së BRUTIT.

Hyjnë PORSHA *dhe* LUCI.

PORSHA.

Të lutem, djalë, rent gjer në Senát;
Mos m'u-përgjiq, po menjëherë shko.
Ç'po pret?

LUCI

Të di psé vete, Zonjë.

PORSHA.

Të desha t'ishe atjé dhe këtú prapë
Gjer sa të them psé të dergónj atjé.
Qëndresë, m'u-forcó; dhe vër një mal
Të lartë midís zëmrës sim'e gjuhës;
Shpirt burri kam, po forcë grúaje.
Sá zor e mbajtka grúaja sekretin!
Këtú më je akoma?

LUCI

Ç' të bënj, Zonjë?
Të rent në Kapitól e asgjë tjatër?
Pastáj të kthehem prap' e asgjë tjatër?

PORSHA.

Pó, lajmëró-m' á është mir' yt-zót,
Se i sëmurë shkoj; dhe vër re mirë
Qesari ç'bën, ç'kërkonjës e rrethojnë.
Vër veshin, djalë; ç'është kjo shamatë?

LUCI

S'dëgjónj asnjë shamatë, Zonjë.

PORSHA.

Vër veshin mirë.
Dëgjova një shamatë si prej lufte,
Q'e pruri era që nga Kapitoli.

LUCI.

Më ndje, moj Zonjë, po s'dëgjónj asgjë. (*Hyn* FALLTARI)

PORSHA.

Eja këtú, or zot; ngá vjen kështú?

FALLTARI.

Që nga shtëpia ime, Zonj' e mirë.

PORSHA.

Sá është ora?

FALLTARI.

Nënt' afrón, moj Zonjë.

PORSHA.

A shkoj në Kapitól Qesari?

FALLTARI.

Jo édhe, Zonjë; vete të zë vënt
T'a shoh kur shkon në Kapitól.

PORSHA.

Mos ke nonjë kërkesë për Qesarin?

FALLTARI.

Tamám një gjë t'atillë kam, moj Zonjë:
Në dashtë dhe në pastë mirësinë
Të më dëgjonjë, i lutem që të ruhet.

PORSHA.

Psé, di që ndodhet më nonjê rezik?

FALLTARI.

S'di gjë, po shumë gjëra munt të ngjajnë.
Mirë mëngjés! Kjo qënka rrug' e ngushtë.
Shumica që pasojnë Jul Qesarin,
Pretorë, senatorë dhe kërkonjës,
Munt të më shtypin mua plakn' e dobët;
Shkonj pra në shesh të hapur dhe atjé
I flas Qesarit math, kur të kalonjë. *(Del.)*

PORSHA

Hynj brënda. Mjera unë! Sá e dobët
Na qënka zëmr' e gruas! Brut i dashur,
T'a shpënçin punën mbarë perënditë.
Pa fjalë, djali më dëgjój *(Me zê të lartë.)* Mark Bruti
Ka një kërkesë që s'ia jep Qesari.
Oh, më bie zalí. Rent, Luc, me vrap
Dhe porosít-më tek imzót; i thuaj,
Jam buzë-qeshur; eja pastáj prapë
Dhe lajmëró-më ç'do t' të thotë.

(Dalin nga anë të ndryshme.)

AKT III

S H K E N Ë I

Romë. Përpara Kapitolit. Mbledhje e Senatit. Një Turmë pópulli; midis tyre ARTEMIDORI *dhe* FALLTARI. *Trumbeta. Hyjnë* QESARI, BRUTI, KASI, KASKA, DECI, METELLI, TREBONI, CINNA, ANTONI, LEPIDI, POPILI, PUBLI, *dhe të Tjerë.*

QESARI.

(Falltarit.) Idat e Marsit ja ku ardhë.

FALLTARI.

Vërtét, Qesár, po nukë shkuan.

ARTEMIDORI.

Falem, Qesár! Këndó këtë shënim.

DECI.

Treboni po ju lutet t' ia këndoni
Me nge këtê kërkesë të përunjur.

ARTEMIDORI.

Këndó mê parë timen; se përkét
Qesarin vetë. O Qesár, këndó-e.

QESARI.

Ç' përkét né vetë mê në funt këndohet.

ARTEMIDORI.

Mos e vonó; këndó-e menjëherë.

QESARI.

Mos ësht' i marrë ky njerí?

PUBLI.

Të lutem, zot, largóh-u së këtejmi .

QESARI.

Kërkesa qýsh më jipni në mes t'udhës?
Eni në Kapitól.

(QESARI *ngjitet në Senát, të tjerët i venë pás. Të gjithë* SENATORËT ngrihen më këmbë.)

POPILI.

(Kasit.) Urónj t' ju vejë puna mbarë sot.

KASI.

Popíl, për ç' punë flisni?

POPILI.

Lamtumirë!

BRUTI.

Ç' të tha Popili?

KASI.

Më tha, na vaftë puna mbarë sot.
Kam frikë q' u-zbulua pllani ynë.

BRUTI.

Vër re, i shkon Qesarit pranë; shih-e.

KASI.

Shpejt, Kaskë, mos na marrin vesh më parë.
Brut, ç'duhet bërë? N' e mësofshin punën,
Qesari a Kasi s' del i gjallë kurrë,
Se vrava veten.

BRUTI.

Kas, qendró si burrë.
Popili nuk i flet për pllanin tonë;
Aý po qesh, Qesari rri i qetë.

KASI.

Treboni s' humbét kohën; Brut, shikó-e,
Sí e largón mënjanë Mark Antonin.

(Dalin ANTONI *dhe* TREBONI. QESARI *dhe* SENATORËT *rrinë mi fronet.)*

DECI.

Kú është Metéll Cimbra. Le t'ia japë
Me vrap Qesarit që taní kërkesën.

BRUTI.

Ka vajtur; shkoni afër dhe i ndihni.

CINNA.

Ti, Kaskë, do të ngresh i pari dorën.

KASI.

Gatí á jemi që të gjithë? Ç' qarje
Shikón taní Qesari me Senatin?

METELLI.

Qesár i lart' i fort' e i shkëlqyer,
Përpara fronit t'unjet Metéll Cimbra
Me zëmër të përunjur. *(Bie mëgjúnjazi.)*

QESARI.

Dëgjó, se duhet të t'a thom, Metéll:
Këto zvarrnísj' e reverenca skllave
Shpesh mallëngjejnë njerës të zakontë
Dhe kthejnë një vendím e një dekrét
Në lodër çilimínjsh. Po mos kujtó
Që gjak rebél Qesari ka në zëmër

Dhe munt metál' i fjesht' i saj të shkrinjë
Me profka për të marrë, fjalë t' ëmbla
E krrusj' e përkëdhelje prej këlyshi.
Yt-vllá u-syrgjynós me një dekrét:
N' u-krrusç, n' u-lutsh, n' u-përkëdhélç për tê,
Si qen të kam për të shkelmuar tutje.
Mësó, Qesari s' bën padrejtësí,
Dhe nuk kënaqet veç me arësye.

METELLI.

S'ka vallë mê të vyër zë se timin
Që tingëllin mê ëmbël për Qesarin
Për tê shpëtuar vllanë nga syrgjyni?

BRUTI.

Dorën të puth, Qesár, po jo për lajkë;
Të lutem, urdhër jip që Pubël Cimbra
Të falet, të çlirohet menjëherë.

QESARI.

Sí, Brut!

KASI.

Fal-e, Qesár; Qesár, e fal;
Në këmbët po të bie edhé Kasi,
Të lutet për çlirímn' e Pubël Cimbrës.

QESARI.

Do t' isha tundur, po t' ju shëmbëllenja:
Sikúr të lútësha dot për të tundur,
Ahere lutjet nofta po më tuntnin;
Po i qëndruar jam si yll' i pollit
Që kurrë s' tundet, kurrë s' luan vendit
E s' ka një shoq në tërë firmamentin.
Me yj pa numër janë shkruar qjejtë,
Me yj, që zjarr na ndritin që të gjithë,
Po një i vetëm nga të gjithë s' lot.

Kështú në botë: shumë njerës ká,
Njerës me trup e gjak e ndjenja,
Po një të vetëm nga të gjithë njoh
Që shkallën mban, e kurrë s' thyhet, s' épet
As tundet dot; dhe q' unë jam aý,
Jua tregónj taní gjer më një pikë,
Se shkela këmbë Cimbra të largohet
Dhe këmbë shkel të mbetet në syrgjýn.

CINNA.

Qesár !

QESARI.

Largóh-u ! S' e ngre dot Olympin !

DECI.

Qesár i math, —

QESARI.

Dhe Bruti bie kot më gjunjë ?

KASKA.

Flisni për mua ju, ô duar ! *(E goditin* QESARIN *me kama.)*

QESARI.

Dhe ti, ô Brut ? Ahere bjer, Qesár ! *(Vdes.)*

CINNA.

Lirí ! Çlirím ! Vdiq tirania !
Shkoni e prokllamójeni në rrugët.

KASI.

Ca hipni në tribunat e bërrtisni :
Lirí, shpëtím, dhe ristoratë !

BRUTI.

Popull dhe Senatorë, mos u-trëmpni !
Mos ikni ; rrini qetë ; ambicja lau borxhin.

KASKA.

Shko në tribunë, Brut.

DECI.

Dhe ti, or Kas.

BRUTI.

Kú është Publi?

CINNA.

Këtú krejt i zalisur nga trazira.

METELLI.

Qëndroni që të gjithë tok mos dalin
Miqt' e Qesarit —

BRUTI.

Ler-e qëndresën. Pubël, mos kij frikë,
S' t' a duam ty a çdo Romàni tjatër
Aspák të keqen ; dhe kështú u thuaj.

KASI.

Dhe shko taní, or Pubël, se ie plak,
E mos të marrin nëpër këmbë turma.

BRUTI.

Tamám ; se bërësit e kësáj pune,
Né vetë do t' i dalim zot. *(Hyn përsëri* TREBONI.)

KASI.

Kú ësht' Antoni ?

TREBONI.

Ka ikur në shtëpí të tij i trëmbur.
Gra, burra, çilimínj po hapin sytë,
Bërrtasin, rendin, sikúr u-príshbota.

BRUTI.

Fat, kemi për të parë ç' na gatít.
Që vdesim doemós një her' e dimë ;
Dhe tërë traga e njeriut është
T' a shtynj' afatin, të fitonjë ditë.

KASKA.

Vërtét, aý që pret njëzét vjet jete
Shpëtón gjithaqë vjet nga frik' e vdekjes.

BRUTI.

Ahere, vdekja është një fitím :
Pra, né e kemi patur mik Qesarin
Që ia shkurtuam frikën q' i kish vdekjes.
Oh únjuni, Romanë, únjuni,
Të ngjýejmë në gjakun e Qesarit
Gjer në bryll dúartë dhe shpatat tona !
Pastáj të dalim jashtë gjer në for,
Dhe dyke shkundur armët përmí kokë,
Le të bërrtasim : „ Paqe dhe lirí ! "

KASI.

Unjuni, láhuni ! Sá shekuj pás
Kjo vepra jon' e lartë do të lohet
Në gjuh' e shtete të palíndura !

BRUTI.

Sá shpesh në shkenë do t' përgjaket ky Qesár,
I shtrirë sot në këmbë të Pompeut
Dhe jo m' i vyer se sa pluhr' i dheut !

KASI.

Dhe aqë herë sa të ngjanjë kjo,
Do të përmëndet edhé lidhja jonë
Me burrat që lirí i dhan' atdheut.

DECI.

Taní á shkojmë ?

KASI.

Pó, vërtét, të gjithë ;
Bruti në krye; do t' ia zbukurojmë

Çapet qê-pás né, burrat, zëmrat
Mê trim' e mê të mira që ka Roma.

(Hyn një SHËRBËTOR.)

BRUTI.

Heshtni ! Kúsh vjen ? Një djal' i Mark Antonit.

SHËRBËTORI.

Kështú, ô Brut, më tha im-zót të t' unjem;
Kështú Antoni tha më gju të bie ;
Kështú më porositi të të them :
Mark Bruti është trim, bujár, i urt, i nderçim ;
Qesari ish i fortë, burrë, mbret, i dashur ;
Thuaj : E dua Brutin, e nderónj ;
Qesár' e ndrúanja, e desha, e nderonja.
Në dhëntë urdhër Bruti që Antoni
Të vinjë shigurísht e të mësonjë
Qýsh vdekjen Jul Qesari meritój,
Qesár' e vdekur s' do t' a donj' Antoni
Sa Brutn' e gjailë; dhe do t' a pasonjë
Midís rezíke e të gjendjes trubull
Me besë. Kështú thot' im-zót Antón.

BRUTI.

Yt-zót është Román i urt' e trim ;
Ashtú e kam besuar gjithënjë.
I thuaj, po të donj' e t' urdhëronjë,
Do të kënaqet ; dhe, për nderin tim,
Ka për të shkuar i pangarë.

SHËRBËTORI.

Ja vajta dhe e solla menjëherë. *(Del.)*

BRUTI.

E di që do t' a kemi mik.

KASI.

E patshim ; mua diç më thotë mëndja
T' ia kemi frikën shumë; dhe përherë
Dyshimi im si djall qëllón ku duhet.

(Hyn përsëri ANTONI.)

BRUTI.

Ja, vjen Antoni. Mark Antón, mirsardhe.

ANTONI.

Qesár i lartë ! Kaqë posht' u-shtrive ?
Të gjitha ngadhënesat e triumfet
Në kaqë pak t' u-shtrydhë ? Lamtumirë !
S' di, zotërínj, ç' qëllime vallë kini,
Kúsh tjatër ka për të pikuar gjak,
E kúsh ka për të rënë si pem' e arrirë.
Për mua, orë më të mirë s' ka
Se or' e vdekjes së Qesarit math,
As gjenden vegla më të výera
Se shpatat túaja q' u-pasuruan
Me gjakun më bujár të botës tërë.
Ju lutem, në më qúani armík,
Taní, me duar gjak të kuq' e tym
Mbarójeni dëshirën. Se sikúr
Të rronj edhé një mijë vjet të tjera,
Veten s' e gjenj kaqë gatí të vdes ;
As vënt as mjet për vdekje s' më pëlqén
Më mirë se këtú pranë Qesarit,
Më mirë se prej jush i prer, i vrarë,
Të zgjedhur mjeshtër-mënt të kohës sotme.

BRUTI.

Antón, mos e kërkó vdekjen prej nesh.
Gjak-pirës, të pashpirtmë dúkemi
Nga duart' e nga vepra jon' e sotme ;

Po mos na shih e na gjykó nga dúartë
Dhe puna e përgjakur që mbaruan ;
Shih zëmrat plot mëshirë, dhe mëshira
Për vojtjet e përgjíthëshme të Romës —
Si shuan zjarri zjarr, mëshír' ashtú mëshira —
Ka bërë këtê punë mi Qesarin.
Për ty, Antón, s'na kanë majë shpatat.
Me krahë hapur, pa fuqí mërie,
Me zëmra vllazërore po të presim
Me dashurí, nderím dhe mirësí.

KASI.

Mê tepër se kujtdó do t' të dëgjohet
Fjala mi ndarjen e ofiqeve.

BRUTI.

Vetëm duró gjer sa të qetësojmë
Pak turmën, që nga frika humbi kokën,
Pastaj do t' të tregojmë arësyen,
Psé unë, q'e kam dashur Jul Qesarin
Kur e godita, psé kështú jam sjellur.

ANTONI.

Për urtësinë tuaj s' kam dyshím.
Të gjithë nemni dúart' e përgjákura :
Mê parë nem' a dorën ti, Mark Brut ;
I dyti nem'a dorën ti, Kaj Kas ;
Pastaj dhe ti, Dec Brut ; dhe ti, Metéll ;
Ti, Cinnë ; ti, trim Kaskë ; ti, Trebón,
I funtm' e jo m' i pakt' i dashurisë,
Të gjithë zotër, — ah, ajmé, ç' të them?
Mi shkitë nderi më qëndrón taní,
Dhe do t' ju dukem nga të dyja një,
A burracák, a lajkëtár i poshtër.
Të desha, Jul Qesár, oh ! ësht' e drejtë ;
Në na shikoftë shpirti yt taní,
Mê tepër se sa vdekja do t' të dhëmbë

Që Mark Antoni yt këtú pajtohet
E zë për dor' armíqt' e tu të gjaktë,
Qesár i lartë, mi kufomën tënde !
Sikúr të kisha sy sa ke ti plagë,
Të qanja, siç të derdhin gjak ató,
Më kish mê tepër hie se kështú,
Që bëhem mik me vrásësit e tu.
Më ndje, Qesár ! Trim dre, këtú të kapnë ;
Këtú më ré ; dhe ja këtú gjahtarët,
Me gjakun tënt të skuqur, të shënuar.
O botë ! ishe pyll' i këtí dreri ;
Dhe ky, ô botë, ishte zëmra jote.
Qýsh më je shtrirë si një dre për-dhé,
Prej kaqë princërsh i goditur !

KASI.

Dëgjó-më, Mark Ontón, —

ANTONI.

Më ndje, Kaj Kas,
Ja ç'do të thon' armíqt' e Jul Qesarit:
Që për një mik kjo është mas' e ftohtë.

KASI.

S'po të qërtónj që m'a lëvdón Qesarin;
Po ç'marrëveshje do të bësh me né?
A do të hysh në qark të miqvet tanë,
A vemi tej, pa pritur gjë prej teje?

ANTONI.

Andáj ju mora dorën, po nga thema
Lëviza kur e pash' atjé Qesarin.
Jam mik me ju të gjithë dhe ju dua
Me shpresën që do t'm'ipni arësyet
Psé, qýsh Qesari ishte i rezikshim.

BRUTI.

Përndryshe, kjo do t'ish një lodr' e egër
Po kemi shkake aqë të shëndosha
Sa dhe i bir'i Jul Qesarit t'ishe
Do të kënáqëshe.

ANTONI.

S'kërkónj më tepër.
Po veç kësáj lyp të më jipet leja
Në for të shpie trupin e Qesarit
Dhe nga tribuna, si një mik q' e pata,
Të mbanj një fjalë në varrím të tij.

BRUTI.

Ke leje, Mark Antón.

KASI.

Një fjalë, Brut. (*Mënjanë* BRUTIT.)
S'di ç'bën; mos i jep leje Mark Antonit
Të flasë në varrim të Jul Qesarit.
A di sá munt të mallëngjehet turma
Nga sa ka për të thenë?

BRUTI.

Kas, më ndje;
Shkonj unë vet'i pari në tribunë
Dhe çfaq përsé e vramë Jul Qesarin;
Sa për Antonin, dekllarónj
Që flet me lejen dhe pëlqimin tonë,
Q'e qúajtmë të drejtë që Qesari
Me nder e pas zakonit të varroset.
Kjo sjell fitím më tepër se sa dëm.

KASI.

S'di ç'do të ngjanjë; nukë më pëlqén.

BRUTI.

Merr trupin e Qesarit, Mark Antón.
Në fjalën funerale mos na kritikó,
Po fol sa munt më mirë për Qesarin,
Dhe thuaj që me lejen ton'e bën;
Se ndryshe nukë munt të marrësh pjesë
Në funeralin; dhe ke për të folur
Nga gjithajó tribunë ku shkonj vetë,
Si të mbarohet fjala ime.

ANTONI.

Tamám, s'kërkónj më tepër.

BRUTI.

Gatítni trupin pra, dhe enj pás.
(*Dalin të gjithë veç* ANTONIT.)

ANTONI.

Oh, ndje-më, copëz e përgjakur dheu,
Që jam i but, i ëmbël me këtá kasapë.
Ti je gërmádh'e burrit më bujár
Që rroj në rrjedhjen e të gjithë kóhëve.
Mjer' dora që ka derdhur këtê gjak të çmuar!
Dhe ja ku të profetësónj mi plagët, —
Gojë nemece buzë-kuqe çelur,
Q'i lypin zë e fjalë gjuhës sime, —
Mallkím mi njérëzit ka për të krisur;
Tërbím i brëndshëm, sherr civíl i egër
Ka për të prérë trupn' e Italis;
Gjak-derdhja, çkatërresa dhe tmerrimet
Do të na bëhen aqë të zakonta
Sa nënat buzë-qeshur do të shohin
Kur foshnjat mun' në djep t'u copëtohen;
Stërvitja n'egërsí mëshirën do t'a mbytë;
Dhe shpirt' i Jul Qesarit del nga Ferri
Me Atën pran'i urët për gjak-marrje

Dhe me zë mbreti po bërrtét kudó:
„Lëshoni qent'e luftës, vrani e preni!"
Të kundërmonjë toka nga kjo vepr'e ndyrë
Më kërma që rënkojnë për varrim! *(Hyn një* Shërbëtór.)
Shërbén Oktáv Qesarin, apó jo?

SHËRBËTORI

Pó, Mark Antón.

ANTONI.

Qesari i shkroj, e ftoj në Romë.

SHËRBËTORI

Letrat e tij i mori dhe po vjen.
Më porositi të të them me gojë — *(Sheh kufomën.)*
O Jul Qesár! —

ANTONI.

U-mallëngjeve, shko mënján'e qaj.
Shoh, dhëmbja ngjitet; sepsé syt'e mi,
Sa panë pika vreri në të tutë
M'u-mvrojtn'e m'u-përlotn'. A vjen yt-zót?

SHËRBËTORI

Nja shtatë lega ndodhet lark nga Roma.

ANTONI.

Ktheh-u me vrap dhe thúaj-i ç'ka ngjarë:
Roma mban zi, Rom' e rezíkshime,
S'ka Roma për Oktavin shigurí;
Shko shpejt, ia thuaj. Po qëndró ca pak;
Më mirë prit këtú gjer sa t'a shpie
Në for kufomën; do të flas atjé
E do të shoh qysh turma e priti veprën
E egër të këtyre gjákësve;
Dhe pas kësáj trego-i Oktavit ri
Qysh është gjendja. Pa më ndih taní.

(Dalin me kufomën e QESARIT.)

SHKENË II

Gjithatjé. Fori.

Hyjnë BRUTI dhe KASI, dhe një Tokicë QYTETARËSH.

QYTETARËT.

Duam shpjegime; némnani shpjegime.

BRUTI.

Pra, éjani, ô miq, dhe më degjoni.
Ti, Kas, të lutem, çap në rrugën tjatër
T'a ndajmë pópullin në mest.
Kush do të më dëgjonjë mua, le të mbetet;
Të tjerët le të shkojnë pas Kaj Kasit;
Dhe do t'jua çkoqitim arësyet
Q'e desh e mir'e Romës vdekjen e Qesarit.

I PARI QYTETÁR.

Unë do të dëgjónj fjalën e Brutit.

I DYTI QYTETÁR.

Unë dëgjónj Kaj Kasin; dhe pastáj
Përqasim arësyet e të dyve.
(Del KASI *me ca prej* QYTETÁRËVE; BRUTI *ngjitet në tribunë.)*

I TRETI QYTETÁR.

Bujari Brut po flet; pushoni!

BRUTI.

Duroni gjer sa të mbarónj. —
Romanë! Qytetarë! Miq! Dëgjómëni që t' jua tregónj punën; dhe heshtni që të muntni të dëgjoni. Në më qúani të nderçim, besómëni, dhe quamëni mjaft të nderçim sa të më besoni. Gjykomëni me mënt, dhe zgjójeni mëndjen që të muntni të gjykoni mê mirë. Në

pastë këtú në këtê mbledhje nonjê mik me zëmër të Qesarit, atí i thom që Bruti e desh Qesarin jo mê pak se aý. Dhe në më pyettë ay mik përsé Bruti u-ngrít kundër Qesarit, përgjígjia ime është kjo: Jo se e desha Qesarin mê pak, po se e dosha Romën mê tepër. A do të deshnit më mirë të rronte Qesari dhe ju të vdisnit robër që të gjithë, se sa të vdiste Qesari dhe të rronit të gjithë të lirë? Qanj për Qesarin, se më deshte; gëzohem, se qé dorë-mbarë; e nderónj, se qé trim; po e vrava se qé ambiciós. I dhashë lote për dashurín' e tij, gas për mbarësín' e tij, nder për trimërín' e tij, dhe vdekje për ambicjen e tij. Kúsh është këtu aqë i poshtër sa të dojë të jetë rop? Në pastë nonjê, le të flasë; për atê kam berë faj. Kúsh është këtú aqë i humbur sa të mos dojë të jetë Roman? Në pastë nonjê, le të flasë; për atê kam bërë faj. Kush është këtú aqë i lik sa të mos dojë vëndin e tij? Në pastë nonjê, le të flasë; për atê kam bërë faj. Qëndrónj dhe pres përgjígjie.

QYTETARËT.

S'ka asnjë, Brut, s'ka asnjê.

BRUTI.

Ahere s' i kam faj asnjeriu. S' i kam bërë Qesarit mê tepër se ç'munt t'i bëni ju Brutit. Çështja e vdekjes së tij do të bisedohet në Kapitól; lavdia e tij nukë do të pakësohet për ató që ish i zoti, as faji i tij, për të cilin u-vrá, nukë do të madhohet. (ANTONI *dhe disá të tjerë hyjnë me kufomën e* QESARIT.) Já ku e siell për të varrosur trupin e tij Mark Antoni, i cili, ndonësé s'pati gisht në vrasjen, po do të përfitonjë nga vdekja e tij dhe do të marrë një vënt në Republikë. Cili prej jush nuk do të përfitonjë? Dhe taní shkonj me këtê fjalë, — që ashtú si e vrava mikun mê tê mirë për të mirën e Romës, me atê kamë do t' i bie dhe vetes, kurdoherë që t'a qúanjë vdekjen time të nevójshime vendi im.

QYTETARËT.

Rroftë Bruti! Rroftë, rroftë!

I PARI QYTETÁR.

Shpjéreni në shtëpí me triumf.

I DYTI QYTETÁR.

Ngréjini statujën pranë stërgjýshërve të tij.

I TRETI QYTETÁR.

Le të bëhet Qesár.

I KATËRTI QYTETÁR.

Kurorëzoni te Bruti virtytat mê të mìra të Qesarit.

I PARI QYTETÁR.

Do t'a shpiem në shtëpí me gas e brohorí.

BRUTI.

O qytetarë, —

I DYTI QYTETÁR.

Pushoni! Heshtni! Bruti flet.

I PARI QYTETÁR.

Pushoni, eh!

BRUTI.

Të dashur qytetarë, lérmëni
Të shkonj i vetëm dhe, për hatrin tim,
Këtú qëndroni bashkë me Antonin.
Ju lutem të nderoni trupn' e Jul Qesarit
Dhe të nderoni fjalën për lavdít' e tij
Që Mark Antoni mban me lejen tonë.
Ju lutem të mos shkonjë asnjerí,
Veç meje, gjer sa të mbarónj Antoni. *(Del.)*

I PARI QYTETÁR.

Qëndroni! Dhe le t'a dëgjójm' Antonin.

I TRETI QYTETÁR.

Pra, le të ngjitet në tribunën lart.
Do t'a dëgjojmë. Eja, Mark Antón.

ANTONI.

Me lejen e Mark Brutit, dal përpara jush. *(Ngjitet.)*

I KATËRTI QYTETÁR.

Ç' po thotë për Mark Brutin?

I TRETI QYTETÁR.

Me lejen e Mark Brutit, thotë, del
Përpara nesh.

I KATËRTI QYTETÁR.

E mir' e tij e dó të mos na thotë
Këtú asgjê të keqe për Mark Brutin.

I PARI QYTETÁR.

Ky Jul Qesari ishte një tirán.

I TRETI QYTETÁR.

Pó, pa dyshím; edhé të lumur jemi
Që Roma ka shpëtuar prej këtí.

I DYTI QYTETÁR.

Pushoni, të dëgjojmë ç' thot' Antoni.

ANTONI.

Romanë bujarë! —

QYTETARËT.

Pushoni! Heshtni, t' a dëgjojmë.

ANTONI.

O miq, Romanë, qytetarë, më dëgjoni.
Vinj t'a varrós, jo t'a lëvdónj Qesarin.
E keqja që ka bërë çdo njerí i mbetet.

E mira i mbulohet shpesh në varr me koskat.
Ashtú i qoftë dhe Qesarit. Trimi Brut
Ju tha taní, Qesari qé ambiciós.
Në paska qën' ashtú, qé faj i rëndë shumë
Dhe rëndë shumë e pagój Qesari.
Këtú, pas lejes Brutit e të tjérëve, —
Se Bruti është burr' i nderçim,
Të nderçim janë që të gjithë, aý dhe shokët, —
Vinj që të flas në funeralin e Qesarit.
Ish miku im, më qé i drejtë dhe i besës.
Po Bruti thotë, qé ambiciós;
Dhe Bruti është burr' i nderçim.
Qesari i solli Romës shumë robër lufte
Dhe arkat me çpërblime ia ka mbushur.
Kjo qé ambicja e Qesarit? Sí ju duket?
Qesari qante kur thërrisnjin të vobektët.
Ambicja duhej t' ish me zëmër më të ashpër.
Po Bruti thotë, qé ambiciós,
Dhe Bruti është burr' i ndreçim.
E patë që të gjithë se në Luperkalet
Tri her' i dhashë një kurorë mbretërore
Edhé tri her' e hodhi; qé ambicje kjo?
Po Bruti prapë thotë, qé ambiciós,
Dhe është, pa dyshím, një burr' i nderçim.
S' dua të kundërshtónj ató që foli Bruti,
Po s' munt t' ju flas përvéç ató që di.
Një her' e deshtë që të gjithë, — jo pa shkak;
Përsé tani s' ju vjen asfare keq për të?
Nër egërsirat paske ikur, ô gjykím,
Dhe njérëzit e paskan humbur arësyen!
Duroni pak, se e kam zëmrën te Qesari,
Atý, dhe pres sa të më kthehet prapë.

I PARI QYTETÁR.

Më duket që na flet me shumë arësye.

I DYTI QYTETÁR.

Po t'a shikoni mirë punën, pati faj
Të math Qesari.

I TRETI QYTETÁR.

Ashtú kujtoni, zotërínj?
Kam frikë mos ia zërë vendin një m' i lik.

I KATËRTI QYTETÁR.

E vutë ré seç tha? E hodhi tej kurorën:
Ahere pa dyshím nuk ish ambiciós.

I PARI QYTETÁR.

Në qoft' ashtú, disá do t'a pagojnë shtrenjtë.

I DYTI QYTETÁR.

I shkreti! i janë bërë sytë zjarr nga lotët.

I TRETI QYTETÁR.

S' ka burrë mê bujár në Romë se Antoni.

I KATËRTI QYTETÁR.

Dëgjoni, se po nis të flasë përsërí.

ANTONI.

Gjer djéthinaj një fjal' e Jul Qesarit
I bënte ballë botës; já taní ku dergjet
Dhe s' ka njerí të vogël mjaft sa t'a nderonjë.
O shokë, po të desha, munt t' ju ndisnja zemrat
Sa t' ju tërbonja e të bënit kryengritje,
Po do t' dëmtonja Brutin edhé Kasin, —
Që janë, siç e dini, njers të nderçim. —
S' dua t'a bënj: mê mirë i bënj dëm
Të vdékurit e vetes sim' e juve
Se sa këtyre njérësve të nderçim.
Pó já një pergamén me vulën e Qesarit!
Ia gjeta në sëndýq; kjo është dhjat' e tij.

Po t'a dëgjoni, qytetarë, këtê dhjatē, —
Që s' kam nër mënt t' jua këndónj, më ndjeni, —
Qesarit vdekur do t'ia puthnit plagët,
Në gjak të tij do ngjýenit shamitë;
Do lypnif për kujtim makár një qime
Dhe kur të vdisnit do t' ua linit djemve
Me testamént si trashëgím të pasur.

I KATËRTI QYTETÁR.

Këndó-na dhjatën; duam t' a dëgjójm' Antón.

QYTETARËT.

Dhjatën! dhjatën! duam dhjatën e Qesarit!

ANTONI.

Duroni, miq, se s' duhet t'a këndónj;
Se s' bën të dini sa ju desh Qesari. —
Se kini gjak, si njerës, s' jini as gur' as drurë;
Se posá t'a dëgjoni dhjatën e Qesarit,
Kam frikë se ju ndez, ju egërsón;
Mê mirë të mos dini që e trashëgoni;
Se po t'a dinit, ç' do të kishte ngjarë!

I KATËRTI QYTETÁR.

Këndó-na dhjatën; duam t' a dëgjójm' Antón.
Këndó-na dhjatën e Qesarit doemós.

ANTONI.

Duroni pak, ju lutem shumë, prisni pak.
Më shkau goja, s' di se si, që jua thashë —
Kam frikë, búrrave të nderçim që e vranë
Qesarin do t' u bëhet dëm; kam frikë!

I KATËRTI QYTETÁR.

Qenë tradhëtorë! Njerës të nderçim atá!

QYTETARËT.

Dhjatën! testamentin!

I DYTI QYTETÁR.

Qenë katilë të pabesë; dhjatën! këndó-na dhjatën!

ANTONI.

Pra, më shtrëngoni t' ju këndónj pa fjalë dhjatën?
Ahere mblídhuni rreth trupit të Qesarit,
Që t' ju tregónj atê që bëri testamentin.
Më jipni leje që të zbres përpósh.

QYTETARËT.

Urdhëroni poshtë.

I DYTI QYTETÁR.

Urdhëroni, zbrisni.

I TRETI QYTETÁR.

Ke leje, si të urdhërósh. *(Antoni zbret.)*

I KATËRTI QYTETÁR.

Bëni një qark; mblídhuni rrotull.

I PARI QYTETÁR.

Híquni nga qivuri; híquni nga kufoma.

I DYTI QYTETÁR.

I hapni vënt bujarit Mark Antón.

ANTONI.

Mos më shtrëngoni ashtú; largóhuni.

QYTETARËT.

Prapë! Hapni udhë! Híquni!

ANTONI.

Në kini lotë, éjani taní t'i derthni.

Të gjith' e njihni këtê togë; e mbanj mënt
Të parën herë kur Qesari e veshi;
Në fushë lufte qé, në tëndë, më të norysur
Një ditë vere kur i mundi Nervianët.
Shikoni, ja këtú goditi kam' e Kasit;
Shikoni sí e çori Kaska plot me cmir.
Këtú e çpoj i dáshuri i zëmrës, Bruti.
Dhe kur e hoqi jashtë thikën e mallkuar,
Shikoni sí i vajti pás dhe gjaku i Qesarit
Sikúr u-súl përjashta që të shohë mirë
Në qé me të vërtetë Bruti që goditi;
Se Bruti, e dini, ishte ëngiëll' i Qesarit.
Ti, Zot, ti vet' e di me ç' mall e desh Qesari.
Kjo ishte çpojtja m' e pashpirtme nga të gjitha.
Kur pá Qesari q' e gaditi dhe aý,
Mosmirë-njohja, mê e fortë se ç' do krahë
Prej tradhëtori, e mundi dhe ia theu zëmrën.
Ahere, si pështolli faqen nënë togë,
Mun' rrëzë monumentit të Pompeut
Që ish ngarkuar gjak, na rá Qesár i Math.
Oh, ç' rënie qé ajó, ô qytetarë!
Ahere un' e ju e gjithë ramë
Dhe na përmbyti tradhësí' e gjaktë.
Oh pó! taní po qani, ju vjen keq;
Dhe lotet po ju rrjedhin drejt nga zëmra.
Sí? Qani, vllezër, si i patë vetëm togën
Qesarit të plagosur? Shihni atê vetë
Q' e kanë bërë shoshë thikë tradhëtorësh.

I PARI QYTETÁR.

O pamje që ngjeth mishin!

I DYTI QYTETÁR.

Qesár, ô trim i mjerë!

I TRETI QYTETÁR.

O dit' e zezë!

I KATËRTI QYTETÁR.

Ah, katilë tradhëtorë!

I PARI QYTETÁR.

O pamje e gjákëshme!

I DYTI QYTETÁR.

Do t' ia marrim gjakun!

QYTETARËT.

Gjakun — rentni, — kërkójini, — dígjini, — zjarr, — vrájini, — thérrini, — mos lëni asnjë tradhëtór të gjallë!

ANTONI.

Qëndroni, qytetarë!

I PARI QYTETÁR.

Pushoni, dëgjoni Mark Antonin.

I DYTI QYTETÁR.

Do t' a dëgjojmë, do t'i vemi pas, do të vdesim me' të.

ANTONI.

Të dashur miq, s' dua aspák t' ju çponj
Sa të rrëmbéheni, të ngrini krye.
Atá q' e bënë këtê punë jan' të nderçim;
S' di ç' shkake të veçanta i kanë shtyrë,
Po janë njerës t' urtë dhe të nderçim
Dhe pa dyshím do t' ju tregojnë arësyet.
Nuk ardha t' ju vjeth zëmrat, vllezër.
S' jam oratór, siç është Bruti;
Po, siç e dini, jam njerí pa djallëzí
Q' e dua mikun tim; këtê e dinë mirë
Atá, andáj më lanë që t'ju flas këtú.
Ah, un' i ziu! S' kam as kokë, as gojë, as sy,

Dhe s' di të flas me mjeshtëri dhe forcë
Që t' i ndes gjakun botës; s' flas veç të vërtetën
Dhe po ju thom ató q' i dini që të gjithë;
Po ju tregónj, ô vllezër, plagët e Qesarit,
Të mjerat gójëra nemece, dhe këtyre u lutem
Të flasin në vënt tim. Po sikúr t' isha unë Bruti
Dhe Bruti Antón, ahere, shokë, Mark Antoni
Do t' ju kish ndezur zëmrat dhe do t' i kish vënë
Çdo plage të Qesarit nga një gjuhë që të ngrente
Jo Romën po dhe gurët për gjakmarrje.

QYTETARËT.

Do të ngríhemi të gjithë.

I PARI QYTETÁR.

Do t' i vëmë zjarr shtëpis' së Brutit.

I TRETI QYTETÁR.

Ejani pra! kërkoni tradhëtorët!

ANTONI.

Pa më dëgjoni, shokë, më dëgjoni.

QYTETARËT.

Pushoni; pa dëgjoni trimin Mark Antón!

ANTONI.

Mor shokë, po ju s' dini përsé shkoni.
Qysh ju fitój 'taní Qesari zëmrat?
Ah, nuk e dini; duhet t' jua them, pra:
Harruat dhjatën, për të cilën ju kam folur.

QYTETARËT.

Dhjatën, vërtét; të rrim' e t'a dëgjojmë.

ANTONI.

Já dhjata, dhe përpósh ka vulën e Qesarit:
I lë sicilitdó Romani qytetár
Për kokë shtatëdhjét e pesë drakma.

I DYTI QYTETÁR.

Qesár shpirt-máth! Ah, do t' ia marrim gjakun.

I TRETI QYTETÁR.

O dorë-mbrét Qesár!

ANTONI.

Kini durím e më dëgjoni.

QYTETARËT.

Pushoni, heshtni! hé!

ANTONI.

Pastáj ju lë gradinat ku shëtitte vetë
Dhe kopshtet e veçantë dhe lulishtat
Përkëtéj Tibrit; juve, bijve tuaj
Jua la t' i kini, t' i shetitni e t' i gëzoni.
Ky ish Qesár! Kúr vjen taní si ky një tjatër?

I PARI QYTETÁR.

Askúrrë, askurrë! Eni, eni, ô búrrani!
T' ia djegim trupin me nderím në tempull
Dhe m' ató ura le t' u vëmë zjarr shtëpive
Të tradhëtórëve. Ngréreni kufomën.

I DYTI QYTETÁR.

Pra, shkoni, sillni zjarr.

I TRETI QYTETÁR.

Sillni ca drrasa.

I KATËRTI QYTETÁR.

Rrëmbeni dyer e dritare dhe ç' të gjeni.

(Dalin QYTETARËT *me Kufomën.)*

ANTONI.

Taní ia shkreptë; intrigë, je më këmbë;
Merr pra çdo udhë që të të pëlqenjë!

(Hyn një SHËRBËTOR.)

Ç' të ra na sjell, mor djalë?

SHËRBËTORI.

Oktáv Qesari, Zot, në Rom' arriu.

ANTONI.

Kú zbriti?

SHËRBËTORI.

Në shpin' e Jul Qesarit me Lepidin.

ANTONI.

Po vinj atjé me vrap t'a vizitónj.
Vjen si me porosí. U-çél, qesh fati,
Dhe sa ka këtê qef, na jep ç' t' i lypim.

SHËRBËTORI.

Më tha se Bruti e Kasi paskan ikur
Kaluar jashtë Romës si të marrë.

ANTONI.

Si duket, pópulli i lajmërój,
Si ua ktheva mëndjen. Shpjer-më te Oktavi. *(Dalin.)*

SHKENË III

Gjithatjé. Një Rrugë.

Hyn CINNA, *Poeti.*

CINNA.

Pash' ëndërr sonte që festova me Qesarin,
Dhe prapësirat m'a rëndojnë kokën;
S' më k' ënda fare të dal jashtë derës,
Po diç më shtyn si me pahír. *(Hyjnë disá* QYTETARË.)

I PARI QYTETÁR.

Sí quhesh?

I DYTI QYTETÁR.

Kú vete?

I TRETI QYTETÁR.

Kú banón?

I KATËRTI QYTETÁR.

Je i martuar a i pamartuar?

I DYTI QYTETÁR.

Përgjígj-u në të gjitha shpejt.

I PARI QYTETÁR.

Pó, dhe shkurt.

I KATËRTI QYTETÁR.

Pó, dhe urtë.

I TRETI QYTETÁR.

Pó, dhe drejt; ashtú t' a dó e mira.

CINNA.

Sí quhem? Kú vete? Kú banónj? Jam martuar a i pamartuar? Dhe të përgjigjem në të gjitha shpejt e shkurt urt' e drejt. Urtë po ju thom që jam i pamartuar.

I DYTI QYTETÁR.

Domethënë janë të marrë atá që martohen. Këtê një herë m' a ke borç. Mê tutje, shpejt.

CINNA.

Shpejt, vete në varrimin e Qesarit.

I PARI QYTETÁR.

Si mik a si armík?

CINNA.

Si mik.

I DYTI QYTETÁR.

Këtù na u-përgjigje shpejt.

I KÁTËRTI QYTETAR.

Kù banón, shkurt.

CINNA.

Shkurt, banónj pranë Kapitolit.

I TRETI QYTETÁR.

Sí quhesh, drejt.

CINNA.

Drejt, quhem Cinnë.

I DYTI QYTETÁR.

Copëtójeni! Është konspiratór.

CINNA.

Jam Cinna, poeti; jam Cinna, poeti.

I KÁTËRTI QYTETAR.

Copëtójeni për vjershat e liga, copëtójeni për vjershat e liga.

CINNA.

S'jam Cinna konspiratori.

I DYTI QYTETÁR.

S' ka të bënjë. E qùajnë Cinnë. Çkúljani pra vetëm emrin nga zëmra dhe léreni të shkonjë.

I TRETI QYTETÁR.

Copëtójeni, copëtójeni! Ejani, djegës! Hájdeni, zjarrvënës! Te shtëpí' e Brutit, te shtëpí' e Kasit! Dígjini të gjitha. Ju, te shtëpí' e Decit, e ju te shtëpí' e Kaskës! Ju, te shtëpí' e Ligarit! Ejani, hájdeni! *(Dalin.)*

AKT IV

SHKENË I

Romë. Një Odë në Shtëpín' e Mark Antonit.

ANTONI, OKTAVI *dhe* LEPIDI, *të ndënjur rreth një tryese.*

ANTONI.

Këtá pra vdesìn; i shënuam emrat.

OKTAVI.

Vdes dhe yt-vllá; Lepíd, á jep pëlqimin?

LEPIDI.

E jap.

OKTAVI.

Shënó-e, Mark Antón.

LEPIDI.

Po me konditën që s' kursehet Publi,
I bir' i satë-motre, Mark Antón.

ANTONI.

S' kursehet; ja, shikó, ia vura pikën.
Lepíd, shko në shtëpín' e Jul Qesarit
E sill-na këtù dhjatën të vëndosim
Qysh të shkurtojmë ca dhurata.

LEPIDI.

Po ju këtú më prisni, qysh?

OKTAVI.

Këtú osé në Kapitól. (*Del* LEPIDI.)

ANTONI.

Ky është burr' i lehtë dhe pa vlerë;
Bën vetëm t'a dërgójm' andéj-këtéj.
A ësht' e drejtë që t'a ndajmë botën
Më trish, dhe ky të marrë njërën pjesë?

OKTAVI.

Posá kështú e ditke, ç' m'a pyete
Kúsh duhet të shënohet për të vdekur
Në listën e proskríptave të zezë?

ANTONI.

Oktáv, jam pak më plak se ti:
Këtê njerí me nderë e stolisim
Që të shpëtojmë nga ca barra e çpifje;
Aý i mban, siç mban gomari arin,
Rënkón, dërsín nga kjo ngarkés' i hequr,
I shtyr' atjé ku ia drejtojmë ecjen;
Kështú thesár' e shpiem ku të duam,
Pastajza ia çkarkojmë, e lëshojmë
Gomár pa kapistáll të shkundë veshët
Dhe të kullosë në luáth.

OKTAVI.

Bëj sí të duash;
Po është trim ushtár dhe i provuar.

ANTONI.

Si kali im, Oktáv; dhe përandáj
I jap tagjí me regull gjithënjê.
Dhe kalin e mësónj qýsh të lëftonjë,
Të kthehet, të qëndronjë, shpejt të rendë,

Po mëndja ime ia drejtón lëvizjet.
Lepidi kështú është në ca pika:
Duhet maësuar dhe stërvitur dhe lëshuar;
Një burrë kokë-zbrazët që ushqehet
Me mjeshtërira dhe me imitata,
Të cilat si i lë, i heth kushdó,
Aý t 'i nis për modë; mos m' a quaj
Veç si një pronë. Dhe tani, Oktáv,
Dëgjó ca gjëra shumë të mëdhá:
Bruti e Kasi janë dyke mbledhur forca;
Duhet t' u bëjmë ballë menjiherë;
Pra, le të ftojmë shokët në kuvênt,
Të shigurojmë miqtë mê të mirë
Dhe të gatitim mjetet mê të mira;
Me vrap pra le të shkoimë në këshillë
Që të zbulojmë çdo rusí të fshehur
E t'i përgjígjemi rezikut hapur.

OKTAVI.

Ashtú po bëjmë; se po na përgjojnë,
Dhe shum' armíq na lehin rreth e rrotull;
Dhe ca me buzë qeshin, po në zëmër,
Kam frikë, kanë miliuna djaj. *(Dalin.)*

SHKENÉ II

Kamp afër Sardit. Përpara Tendës së Brutit.
Daulle. Hyjnë BRUTI, LUCILI, LUCI *dhe* USHTARË;
TITINI *dhe* PINDARI *u dalin përpara.*

BRUTI.

Qëndroni, ej!

LUCILI.

Jipni parullën dhe qëndroni, ej!

BRUTI.

Ç' të ra, Lucíl? A u-afrua Kasi?

LUCILI.

Pó, u-afrua; dhe Pindari ardhi
T' ju sallutonjë n' emrin e të zotit.

(PINDARI *i jep një letër* BRUTIT.)

BRUTI.

Më shkruan mirë. Zoti yt, Pindár, —
A vet' aý a me të liq zyrtarë —
Me gjërat që ka bërë më shtrëngój
Të dëshërónj të mos i kishte bërë.
Po posá t' urdhëronjë, do të flasim.

PINDARI.

Nuk kam dyshím që zoti im bujár
Ashtú sikundër është do t ju duket,
Njerí me nder e dignitét.

BRUTI.

S' dyshónj aspák për tê. Lucíl, një fjalë:
Më thuaj sí të priti?

LUCILI.

Me nder e me fisnikërí të mjaftë,
Po jo me zëmër e mënyrë shoku
As me fjalím të lir' e miqësór,
Si kish zakón më parë.

BRUTI.

Më përshkrove
Si ftohet miku i ngrohtë. Shih, Lucíl,
Kur dashuria nis të dobësohet,
Përdór ceremonira të pahirta;
Se bes' e fjesht' e kthjellët lodra s' ka.
Të zbrázëtit, si kuaj të hazdisur,

Tregojnë me shamatë forc' e sulmë;
Po kur e ndjejnë yzengjín' e gjaktë,
Në çast u bie përçja dhe përmbysen
Si mëza të pabesa në provím.
A vjen dhe ushtërí' e tij?

LUCILI.

Në Sard mejtohen t'a kalojnë natën;
Po pjes' e madhe, dhe kalorësia
Përgjithërísht, me Kasin kanë ardhur.

BRUTI.

Dëgjó! arriu. *(Marsh i ngadalshëm përbrënda.)*
Dil, prit-e mirë. (*Hyjnë* KASI *dhe* USHTARË.)

KASI.

Qëndroni, ej!

BRUTI.

Qëndroni, ej! Jipni parullën tutje!

I PARI USHTÁR.

Qëndroni!

I DYTI USHTÁR.

Qëndroni!

I TRETI USHTÁR.

Qëndroni!

KASI.

I dashur vlla, m' a hëngre hakën.

BRUTI.

Për Zotin! S' ia há hakën as armikut.
Ahere, qýsh ia há dot hakën vllajt?

KASI.

Kjo sjellje e paánëshme, ô Brut,
Mbulón padrejtësí; dhe kur e bën —

BRUTI.

Mê qetë, Kas; ngadale çfaq-i qarjet;
Se të njoh mirë. Pra, le të mos zihemi
Këtú përpara ushtërive tona,
Që s' duhet të na shohin veç si miq.
U thuaj të largohen; dhe pastáj
Në tendën time, Kas, shpjegóm'i ankesat
Dhe kam për të dëgjuar me vërejtje.

KASI.

Pindár, u thuaj kumandárëve
T' a shpien ushtërinë pak mê tej.

BRUTI.

Lucíl, bëj gjithashtú dhe ti;
Në tendën të mos lësh njerí të hynjë
Sa pa mbaruar konferencën tonë.
Titini e Luci derën le të rúajnë. *(Dalin.)*

SHKENË III

Përbrenda Tendës së Brutit.

Hyjnë BRUTI *dhe* KASI.

KASI.

Që m' a ka ngrënë hakën duket sheshit:
Luc Pellën e dënove shumë rëndë,
Se Sardiánëve ryshfét u merrte;
Dhe letrat që të shkrova në favór të tij,
Q' e njoh njerinë, s' i përfille fare.

BRUTI.

Ia hëngre vetes hakën kur më shkrove.

KASI.

Në kohë, si e sotmja, s'ësht' e udhës
Të vihet re çdo vogëlimë faji.

BRUTI.

Nem leje të të them që dhe për ty
Bërrtasin bota që je dorë-prishur,
Që shet e tregëtón për ar ofiqet
Nëpër zyrtarët.

KASI.

Unë dorë-prishur!
Di që je Bruti dhe më flet kështú,
Se tjatër fjalë s' flisnje më, për Zotin!

BRUTI.

Emri këtê korruptë t' a mbulón
Dhe ia ndalón punitjen.

KASI.

Sí! punitjen!

BRUTI.

Marsin kujtó! Kujtó idat e Marsit!
Për drejtësí Qesár' á nuk e vramë?
Kúsh trupin ia ka ngar' e çpuar
Veç se për drejtësí? Qýsh një prej nesh,
Që vrau burrin mê të math të botës.
Nga që përkrahte vjédhësit, qýsh né
Po ndyjmë me ryshfete dúartë
Dhe shesim nder' e gjerë dhe të lartë
Për kashtra që m' i kap me grusht kështú?
Mê mir' u-bëfsha qen e lehça kundër hënës
Se sa Román i tillë!

KASI.

Mos më leh;
S' e durónj dot; e humbe kokën fare;

Në branga më ke vënë. Jam ushtár
M' i vjetër në praktikë dhe m' i zoti
Se ti që t' imponónj kondíta.

BRUTI.

Fol sá të duash; nukë je aspák.

KASI.

Jam.

BRUTI.

Unë thom që s' je.

KASI.

Më tepër mos më ngaj, se humba kokën;
S' t'a dó shëndeti; mos më çpo më tepër..

BRUTI.

Hajde, mor burr' i lehtë!

KASI.

A ësht e mundur?

BRUTI.

Dëgjó-më, se taní kam për të folur.
Mos duhet t' i hap udh' inatit tënt?
Të trëmbem kur skërrmitet një i marrë?

KASI.

O Zot, ô Zot! Qýsh t' i durónj këtó?

BRUTI.

Këtó! Më tepër: çir-u sa të çfryhesh;
Çap dhe tregój-u skllévëve të tu
Sá je gjak-ndezur dhe i bëj të dridhen.
Mos dó të t' unjem? të të përkëdhél?
Të rri të të zvarrnisem pas kapriçit?
Për perënditë, tret-e vrer' e barkut
Dhe sikúr të pëlcáç; sepsé që sot

Do t' të përdór për tallje dhe përqeshje
Kur m' egërsohesh si një grerë.

KASI.

Këtú paska arrirë puna ?

BRUTI.

Më qënke, thua, një ushtár m' i mirë :
Tregó-e pra; provó-e mburrjen tënde
Dhe do të më kënaqësh. Sa për mua,
Mësime marr me gas nga më bujarët.

KASI.

Më çart me gjithëséj, ô Brut, më çart ;
Ushtár m' i vjetër, thashë, jo m' i mirë ;
„ M' i mirë " mos kam thënë ?

BRUTI.

Dhe sikúr t' a kesh thënë, s' më há malli.

KASI.

S' kuxonte as Qesari të më çponte kaqë !

BRUTI.

Pushó, pushó, s' kuxonje ti t' a ngisnje aqë !

KASI.

S' kuxonja !

BRUTI.

Jo.

KASI.

S' kuxonja, the, t' a ngisnja ?

RRUTI.

Për kokën tënde nuk kuxonje.

KASI.

Mi dashurinë time mos shkel tepër,
Se do të bënj një gjë që s' më pëlqén.

BRUTI.

E bëre atê gjë që s' tê pëlqén.
S' më tremp dot, Kas, me këtó kërcënime;
Me nder jam armatisur aqë fortë
Sa më kalojnë si një er' e kottë
Që veshi s' m' a përfill. Të lypa
Ca suma ári, dhe m'i refuzove;
Se s'mbleth dot ar me mjete poshtërake:
Për qjell, më mirë pres monedhë zëmrën
Dhe gjakun derth për drakma se të çkul
Nga dor'e ashpër e fshatárëve
Parán'e mjerë me shtrëngés'e shtrydhje.
T'i lypa të paguanj legjionat,
Po m'i mohove. Kjo á të ka hie?
Lakmonjës i atillë kur të bëhem
E t'i mohónj rezíl-paranë mikut,
O perëndira, krísmani rrufenë
Dhe copëtómëni.

KASI

S' t'i refuzova.

BRUTI.

Pó.

KASI

Jo; ishte i marr' aý që solli
Përgjígjien time. Brut, m'a theve zëmrën
Mungesat mikut miku ia durón,
Po ti m'i bën mê të mëdhá se ç'janë.

BRUTI.

Jo, veç se kur po m'i zbatón mi kokë .

KASI

S' më dó.

BRUTI.

S't'i dua cenet.

KASI

Sy miku nuk i sheh t'atija cene.

BRUTI.

Sy lajkëtari nuk i sheh, pa qofshin
Mê të mëdhá se sa Olýmp'i lartë.

KASI

Hajde, Antón! Hajde, Oktáv i ri!
Ejani, gjakun Kasit vetëm mérrjani,
Se Kasi u-lóth nga jet' e kësáj bote;
Se e urrén i dáshuri dhe miku;
Se e ndërsén i vëlláj dhe e përbúz si skllaf;
Ia vë re cenet, në deftér ia shkruan,
Me gojë ia mëson, ia nëmërón
Dhe ia vërvít për sysh. Oh, munt të qanja
Me lote shpirtin tim! Ja kama ime,
Ja gjoksi im i hapur; ja një zëmër,
M'e shtrenjtë se sa minat e Plutonit,
M'e vyer se sa ári; çkulm'a jashtë,
Në qofsh Román; ja unë, un' i cili
Të paskam refuzuar ar, t'ap zëmrën.
Godít si mi Qesarin; se e di
Se, kur më keq po e urrenje, ahere
E deshe ca mê mirë se sa Kasin.

BRUTI.

Në myll vër kamën; zëmëróm'u kur
Të duash, se ashtú e dashka puna;
Ç'të duash bëj, çnderimi qënka qef.

O Kas, je shoqëruar me një shqerë,
Q' e mban mërinë si çakmaku zjarrin,
Që me pahír e shpejt lëshón shkëndijë
Dhe ftohet prapë menjëherë.

KASI.

Mjer' unë, paskam rrojtur që të bëhem
Shakaja dhe përqéshj' e Brutit tim,
Kur më ndes vreri, gjaku i përzier.

BRUTI.

Dhe unë vetë fola gjak-përzier.

KASI.

Ashtú më thua, qënka? Nem'a dorën.

BRUTI.

Dhe zëmrën' bashkë.

KASI.

O Brut!

BRUTI.

Ç' ke? Ç' është?

KASI.

S' më paske dashur mjaft sa të durósh,
Kur gjaku i nxehtë që më dha im-më
Më bën të humbás kokën?

BRUTI.

Pó, që sot
Kur të më zëmërohesh përtéj masës
Thom, më qërtón jot-ëmë, dhe s' vë re.

(Shamatë përbrënda.)

POETI.

(Përbrënda.) Dua të hynj, të shoh pak gjeneralët,
Se janë zënë midís tyr' e s' bën
Të mbeten vetëm.

LUCILI.

(Përbrënda.) Nukë hyn dot brënda.

POETI.

(Përbrënda.) Asgjê nuk më ndalón veç vdekjes.
(*Hyn* POETI, *i pasuar prej* LUCILIT, TITINIT, *dhe* LUCIT.)

KASI.

Ç' ke, ti? Ç' kërkón?

POETI.

Turp, turp, ô gjeneralë! Ç' bëni ashtú?
Pajtóhuni, si ju ka hie, miq me tru,
Dëgjômëni, se jam mê plak se ju.

KASI.

Ha! ha! sá poshtër na rimón ciniku!

BRUTI.

Lagóh-u së këtejmi, mor rezíl!

KASI.

Duró-e, Brut; ashtú e ka zakón.

BRUTI.

Ia pres shakanë kur të presë kohën.
Në luftë ç' punë ka ky pafllatár?
Or, shok, largóh-u!

KASI.

Hajde, hajde, shko. (*Del* POETI)

BRUTI.

Lucíl, Titín, u thoni kumandárëve
T' i shpien legjionat për të fjetur.

KASI.

Dhe kthéhuni e síllnani Messalën
Me vrap këtú. (*Dalin* LUCILI *dhe* TITINI)

BRUTI.

Luc, një poçe verë. (*Del* LUCI.)

KASI.

S' e dinja q' aqë shumë munt të ndizesh.

BRUTI.

O Kas nga hidhërimet iam sëmurur.

KASI.

Nuk e përdór fillosofinë tënde pra,
Kur epesh në mjerime aksidentale.

BRUTI.

Mjerimin s'e durón askúsh mê mirë
Se unë. Porsha vdiq.

KASI.

Sí? Porsha!

BRUTI.

Vdiq.

KASI.

Sí nuk më vrave kur të ngacëmova?
O humbj' e paduruar që ther zëmrën!
Po nga ç' sëmundje?

BRUTI.

S' e duronte ndarjen
Dhe helmin që Oktavi e Mark Antoni
Kishin arrirë të forcohen aqë, —
Se vdekj' e saj me këtó lajmë m' ardhi —
Nga kjo e humbi mëndjen, u-shastís
Dhe, kur e lanë vetëm, kish gëlltitur zjarr.

KASI.

Dhe vdiq kështú?

BRUTI.

Tamám.

KASI.

O perëndira!
(Hyn përsëri LUCI *me verë dhe qirínj.)*

BRUTI.

Mos m'a kujtó më. Nem një kupë verë.
Këtú po mbyt çdo ashpërsí, ô Kas. *(Pi.)*

KASI.

Kam etje zëmre për këtê zotím bujár.
Mbush kupën, Luc, me verë sa të derdhet.
S' pi dot askurrë tepër dashurín' e Brutit. *(Pi.)*

BRUTI.

Titín, hyr brenda.
(Del LUCI. *Hyn përsëri* TITINI *me* MESSALËN.)
Urdhëró, Messalë.
Tani pra, le të rrimë rreth qiririt
Të bisedojmë për nevojat tona.

KASI.

Na shkove, Porshë?

BRUTI.

Mos më tej, të lutem.
Messalë, pas këtyre létrave
Oktáv' i ri dhe Mark Antoni zbresin
Që të na bien me një ushtërí të fortë
Dhe në Filíp shpeditën e drejtojnë.

MESSALA.

Ashtú më thonë letrat edhé mua.

BRUTI.

Me ç' farë shtese?

MESSALA.

Që me proskrípt' e urdhër çligjësór
Oktavi, Mark Antoni dhe Lepidi
Na kanë vrarë një qint senatorë.

BRUTI.

Në këtë pikë letrat s' na ujdisin.
U-vranë shtatëdhjetë senatorë,
Më shkrúajnë, me Ciceronin bashkë.

KASI.

Me Ciceronin bashkë!

MESSALA.

Ciceroni u-vrá
Me këtë urdhër e këtë proskriptë.
Nga zonja letr' á more, Imzót?

BRUTI.

Jo, Messalë!

MESSALA.

Asgjë për të s'të shkrúajnë në letrat?

BRUTI.

Asgjë, Messalë.

MESSALA.

Duket si çudi.

BRUTI.

Përsé pyét? Ty á të shkroj dikúsh?

MESSALA.

Jo, Imzót.

BRUTI.

Më thuaj të vërtetën, si Román.

MESSALA.

Dhe ti dëgjó-e të vërtetën, si Román:
Vdiq sakt, e me mënyrë të çudiçme.

BRUTI.

Ahere, Porsh' e dashur, lamtumirë!
Një ditë vdesim doemós, Messalë;
Dhe dyke ditur që nga kjo s' shpëtonte,
Po e durónj taní këtê mjerím.

MESSALA.

Kështú durón i madhi vrer të math.

KASI.

Jam i stërvitur në këtê sa ti,
Po zëmra s' m'a duronte gjer atý.

BRUTI.

Taní, në punë shpejt. Sí thua, Kas?
A nisemi me vrap për në Filíp?

KASI.

S' më duket pun' e urtë.

BRUTI.

Për ç'arësye?

KASI.

Ja përsé:
Mê mir' e lëm' armikun të na gjenjë;
Harxhohet, loth ushtarët e dëmtohet,
Kur né, në defensivë, rrimë qetë
Dhe jemi plot me çlodhj' e çkathësí.

BRUTI.

Të mirat arësye duhet t'unjen
Përpara më të mírave. Krahina .
Që nga Filipi gjer këtú ku jemi
Po na çëndrón në bindje të pahirtë,
Dhe na kontribuón me murmuritje;
Armiku, dyke shkuar midís saj,
Ka për të plotësuar ushtërinë,
Vjen freshk, i rritur dhe i trimëruar;
Kur nga këtó avanta e shkurtojmë,
N' i bëfshim ballë në Filíp atjé,
Dyke e lënë këtè popull prapa.

KASI.

Dëgjó-më, vlla i dashur.

BRUTI.

Të lutem. Duhet vënë re pastáj
Që s' kemi ç' të kërkojmë më nga miqtë,
Që legjionat tona janë krejt të plotta,
Që çështja jon' është e arrirë.
Armiku ynë rritet dita-ditës;
Né mun' në majë, nism' e zbresim.
Në punët njerëzore ká një valë:
E kape, kur u-ngrít, je i fituar;
E lé, dhe udhëtím' i tërë jetës
Fundós në cekësí e në mjerime.
Mi det të kolmë po plevasim sot;
A vemi si pas rrjedhjes kur na ndih,
A mbýtemi me gjith' anien bashkë.

KASI.

Ahere, pas dëshirës sate, nis-u.
Né vijmë pás, dhe i përballim në Filíp.

BRUTI.

Ka përparuar nata kur po flisnim;
Natyra jonë bindet në nevojë
Dhe duhet t'a kënaqim me pak çlodhje.
A kemi fjalë tjatër?

KASI.

Jo, s'kemi tjatër gjë. Natën e mirë!
Ngríhemi nesër shpejt e nísemi.

BRUTI.

Luc! *(Hyn përsëri* LUCI.) Gunën. *(Del* LUCI.)

Trim Messalë, mirë váfsh!
Titín, natën e mirë! Kas bujár,
Natën e mirë dhe u-gdhífsh shëndoshë!

KASI.

O vlla i shtrenjtë! E nismë natën keq.
Kështú mos na u-ndafshin shpirtet kurrë!
Askurrë, Brut!

BRUTI.

Çdo gjë u-ndréq tani.

KASI.

Natën e mirë, Imzót!

BRUTI.

Vlla, mirë váfsh!

TITINI dhe MESSALA.

Natën e mirë, Imzót.

BRUTI.

Të gjithë ô shokë, mirë vafshi.

(Dalin KASI, TITINI *dhe* MESSALA. *Hyn përsëri* LUCI *me gunën e natës.)*

Nem gunën. Kú e ke shtrumentin?

LUCI.

Këtú në tendë.

BRUTI.

Sí? Të flihet prapë?
S't'a heth për faj, se vigjëllove tepër.
Thirr Klavdin me ca djem të mi të tjerë
Të flenë mi jastëk në tendën time.

LUCI.

Varrón! Eh, Klavd! *(Hyjnë* VARRONI *dhe* KLAVDI.)

VARRONI.

Na thirre, Imzót?

BRUTI.

Ju lutem, djem, këtú u-shtrini e flini;
Se nofta për së shpejti do t'ju zgjonj
Që t'ju dërgónj për punë pranë Kasit.

VARRONI.

Po t'urdhërósh, qëndrójm' e rúajmë.

BRUTI.

Aspák, or djem, po shtríhuni e flini.
Se nofta pasandáj ndrronj mëndje.
Shih, Luc, ja libra që kërkonja aqë;
Në xhep të gunës sim' e kisha vënë.

(VARRONI *e* KLAVDI *shtrihen e flenë.)*

LUCI.

Qesh' i shigurtë që s'm'a kishe dhënë.

BRUTI.

Më ndje, or bir, jam shumë harrovaç.
A munt t'i mbash pak çelur syt' e rëndë
Dhe të më loç ca këngë në shtrumént?

LUCI.

Si t' urdhërósh, Imzót.

BRUTI.

Loj pak, mor djalë;
Të mërzít tepër, po shikónj që dó.

LUCI.

Imzót, e kam detyrë.

BRUTI.

S' bën të t'a shtynj detyrën tej fuqisë;
E di që djémave të rinj u flihet.

LUCI.

Kam fjetur pak, Imzót, më parë.

BRUTI.

Ke bërë mir' e prapë do të flesh;
S' të mbanj fort gjatë; eja; dhe në rrofsha
Kam për të qën'i mirë kundréjt teje. *(Muzikë dhe Këngë.)*
Haváz i fjetur ky; ô gjumë vrasës!
Ia vure panxhën plump mi sytë djalit
Që të këndón? Pra, bir, natën e mirë!
S' t'a prish dot qetësín' e nuk të zgjonj;
Po në dremítsh, shtrumentin do t'a thyesh;
T' a marr nga dora pra; dhe mirë váfsh!
Të shohim; s' e shënova vallë faqen
Gjer kú këndova die? Ja ku qënka.

(*Hyn* FANTAZMA *e* QESARIT.)

Sá drit' e keqe! — Eh! kúsh ësht atý?
Besónj se dobësí' e syrit tim
Formón këtê fantazmë monstruoze.
Ja ku po vjen mi mua. A je gjë?
Vall' á je perëndí a djall a ëngjell
Që m'a ngrin gjakn' e m'a ngre qimen drizë?
Më thuaj, ç' je?

FANTAZMA.

Shpirita jot' e keqe, Brut.

BRUTI.

E ç' vjen këtú?

FANTAZMA.

Vinj të të them se në Filíp më sheh.

BRUTI.

Të shoh pra prapë në Filíp?

FANTAZMA.

Pó, në Filíp.

BRUTI.

Të shoh pra në Filíp. (FANTAZMA *çduket.*)
Taní q' u-çdúk, e mblodha prapë veten.
Shpirít' e keqe, desha të të flisnja
Mê gjatë pak. Luc! Klavd! Varrón!
U-zgjoni, djema! Klavd!

LUCI.

Imzót, janë çkurdisur kordhat.

BRUTI.

Ky thotë se po lot shtrumentin édhe.
Pa zgjoh-u, Luc!

LUCI.

Imzót.

BRUTI.

Pé ëndërr, Luc, që më bërtite ashtú?

LUCI.

Imzót, s' di në bërtita apó jo.

BRUTI.

Bërtite, pó. A pé gjësendi?

LUCI.

Asgjê, Imzót.

BRUTI.

Fli prapë, Luc. Eh, Klavd! or djalë zgjoh-u!

VARRONI dhe KLAVDI.

Imzót!

BRUTI.

Përsé, or djem, bërtitt' ashtú në gjumë?

VARRONI dhe KLAVDI.

Po á bërtítmë, Imzót?

BRUTI.

Bërtittë, pó. A patë gjâ?

VARRONI.

Jo, s' pashë gjë, Imzót.

KLAVDI.

As unë, Imzót.

BRUTI.

Pra, shkoni, sallutómëni vlla Kasin,
I thoni me fuqít' e tij të niset
Përpara shpejt, dhe né i vijmë pás.

VARRONI dhe KLAVDI.

Si urdhërón, Imzót. *(Dalin.)*

AKT V

SHKENË I

Fush' e Filipit.

Hyjnë OKTAVI, ANTONI *dhe* USHTËRIA *e tyre.*

OKTAVI.

Ja, Mark Antón, na dolla si shpresonim:
Më the q' armiku nukë do të zbriste,
Po do t' qëndronte nëpër brigjet lart;
Po s' ngjan ashtú; gatiten për betejë,
Mejtohen të na bien në Filíp këtú
Dhe na përgjigjen para se t' i çpojmë.

ANTONI.

U jam në shpirtin brënda dhe e di
Përsé e bëjnë; pa do t' u pëlqente
Më mirë t' ishin gjetkë; dhe na zbresin
Me trimërín' e frikës, që me dukjen
Të na provojnë sá kurajë kanë;
Po s' ësht ashtú aspák.

(Hyn një LAJMËTÁR.)

LAJMËTARI.

Gatítuni, ô gjeneralë!
Armiku vjen me pamje trimërore,
Na ngriti flámurin e kuq të luftës
Dhe duhet diç të bëjmë menjiherë.

ANTONI.

Oktáv, hiq me ngadalë më të mëngjer
Fuqít' e tua te kjo fush' e hapur.

OKTAVI.

Ti më të mëngjër, unë më të djathtë.

ANTONI.

Përsé prish punë në këtê shtrëngesë?

OKTAVI.

S'prish punë; po ashtú kam për të bërë.

(Marsh. Daulle. Hyjnë BRUTI, KASI, *dhe* USHTËRIJA *e tyre;* LUCILI, TITINI, MESSALA *dhe të Tjerë.)*

BRUTI.

Qëndruan dhe kërkojnë të fjalosen.

KASI.

Qëndró, Titín, të dalim e t'u flasim.

OKTAVI.

Antón, á t'apim shenjën e betejës?

ANTONI.

Jo, po përgjígjuni kur të na bien.
Eja, se gjeneralët duan fjalë.

OKTAVI.

Pra, mos lëvisni gjer sa t'ipet shenja.

BRUTI.

Mê parë fjalë dhe pastáj goditje.
Kështú a jo, ô bashkë-qytetarë?

OKTAVI.

Jo se i duam fjalët, siç i doni.

BRUTI.

Fjalët e mira vlejnë ca mê tepër
Se sa goditjet e këqia.

ANTONI.

Goditjet e këqia ti, ô Brut,
Me fjalët mê të mira i stolís.
Kështú ia çpove Jul Qesarit zëmrën,
Dyke bërtitur: „Rroftë Jul Qesari!"

KASI.

Antón, kú shtie me goditjet s'dihet;
Po sa për fjalët, di me tó të vjedhësh
Mbletët e Hyblës e t'i lësh pa mjaltë.

ANTONI.

Po jo pa thump.

BRUTI.

Oh pó, pa zë bilé.
Se ua vodhe gumëzhitjen, ô Antón,
Dhe di të kërcënósh me urtësí
Para se të gjëmbósh me thumbin.

ANTONI.

Të poshtër tradhëtorë! Kështú s'flisnít
Kur kamat të pabesa túaja
Goditnë Jul Qesarin prapa kráhëve;
Më qeshnit si majmún' e si këlyshë,
Më përkëdhélëshit e m'únjëshit
Si skllev' e puthnit këmbët e Qesarit,
Kur Kaska i mallkuar, i pabesë,
Në zverk i ra Qesarit. Lajkëtarë!

KASI.

Né lajkëtarë! Brut, tani dëgjó-e!
Kjo gojë sot s'na shante dot kështú,
Sikúr t'ish bërë siç të thashë unë.

OKTAVI.

Eni në punë: Munt të na dërsini
Me argumenta, po s' na jipni prova
Veç se me pikat mê të kuqe gjaku.
Kundër konspiratórëve nxjer shpatën!
Dhe kúr besoni do t'a vë në myll?
Askurrë gjer sa t'i kem çgjakësuar
Të tridhjét' e tri plagët e Qesarit,
Askurrë gjer sa një Qesár i ri
T'ua dërrmonjë shpatat tradhëtórëve.

BRUTI.

Qesár, s'të vret dot tjatër tradhëtór
Përvéç atyre që ke pás me vete.

OKTAVI.

Vërtét, besónj, s'kam lindur që të vdes
Nga shpat' e Brutit.

BRUTI.

Dhe më bujár' i giindjes sate t'ishe,
Mor djalë, nukë vdisnje dot më bukur.

KASI.

Çun shkolle i mvrojtur, q'atê nder s'e vlen,
Q' u-lidhe me një maskará pjaník.

ANTONI.

Ti, Kas akoma me të vjetrat!

OKTAVI.

Haide, Antón, të shkojmë! Tradhëtorë!
Turinjve ju vërvitim sfidën: eni,

Në daçi të lëftoni, dilni sheshit;
Në mos, po kur t'ju mbanjë barku.
(Dalin KTAVI, ANTONI, *dhe* USHTËRIA *e tyre.)*

KASI.

Taní, fry erë, val' u-frý, rent barkë,
Furtuna krisi, dhe kú dashtë daltë.

BRUTI.

Lucíl, dëgjó një fjalë të të them.

LUCILI.

Imzót? (BRUTI *dhe* LUCILI *flasin mënjanë.)*

KASI.

Messalë!

MESSALA.

Urdhëroni, gjenerál.

KASI.

Messalë! Sod kam ditë-lindjen time,
Se pikërísht si sot ka lindur Kasi.
Messalë! Nem' a dorën; jij dëshmór
Se sot, pa dashur, si dikúr Pompeu,
Jam i shtrënguar që t'i rezikónj
Në një betejë gjith' liritë tona.
Ti di që kam pasuar me qëndresë
Doktrinat Epikuriane; sot
Kam ndrruar mëndje, nisa të besónj
Gjer më një pikë shenjat profetike.
Mi krye-flamur, kur nga Sardi vinim,
Dy shkaba të mëdhá zbritn' e qëndruan
Dhe hanin bukë nga ushtarët tanë
Dhe na përcúallë gjer në Filíp.
Këtë mëngjés na ikn' e na u-çduknë,
Dhe korbat, sorrat ua zunë vëndin,
Na fluturojnë lart e na shikojnë

Si gjah të ngordhur dhe na hedhin hien
Si një mbulesë funerale, ku
Na dergjet ushtëria, na jep shpirt.

MESSALA.

Mos e besó.

KASI.

Nuk e besónj veç pjesërísht,
Se e kam frymën fresk' e kam vëndosur
T'i bënj rezikut ballë burrërísht.

BRUTI.

Kështú, Lucil; bëj si të thashë.

KASI.

Taní, i dashur Brut,
Na ndihçin perënditë sot, e muntshim
Në paq' e dashurí të mplákemi.
Po puna e njeriut s'ësht' e saktë;
Në sy pra le të marrim mê të keqen.
Në qoftë se humbasim sot betejën,
Kjo është her' e funtme që po flasim.
Ahere ç'ke vëndosur që të bësh?

BRUTI.

Si pas fillosofisë që besónj,
Dënova vetë-vrasjen e Katonit;
S' di qýsh po, jam i mëndjes, është gjë
Frikaçe dhe e poshtër t'a shkurtojmë jetën
Nga tmerri i së pritmes; pra, mejtónj,
I armatisur me durím e shpresë,
T'i unjem providencës së fuqive
Të larta që po regullojnë botën.

KASI.

Ahere pra, n'e humpçim sot betejën,
A je gatí që rrúgëve të Romës
Të të zvarrnisin me triúmf?

BRUTI.

Jo, Kas; Román bujár, mos e besó
Që Bruti shkon në Rom' i lidhur gjallë,
Se është tepër kryelartë; pra,
E sotmja punës Marsit i jep funt.
S' e di á píqemi dot tjatër herë;
Për gjithënjê shëndet pra le të lëmë:
Për jetë dhe për jetë lamtumirë, Kas!
N' u-pjekshim prapë, do të buzëqeshim,
Në mos, po jemi ndarë fare mirë.

KASI.

Për jetë dhe për jetë lamtumirë, Brut!
N' u-pjekshim prapë do të buzëqeshim,
Në mos, vërtét u-ndamë fare mirë.

BRUTI.

Përpara pra! Oh, sikúr të muntnim
T'ia dinim fundin ditës sa pa ardhur;
Po na mjaftón që dita na mbarón,
Dhe fundin ia mësojmë. Hajde, shkojmë! *(Dalin.)*

SHKENË II

Gjithatjé. Fush' e Betejës.

Allarmë. Hyjnë BRUTI dhe MESSALA.

BRUTÌ.

Rent, rent, Messalë; këtê urdhër jip
Në legjionat t'anës tjatër tej. *(Allarmë e fortë)*
Le të vërviten menjëherë; shoh
Një ftoftësí në krahun e Oktavit,
Dhe i përmbýs një e papritur sulmë.
Rent, rent, Messalë! thúaj-u të zbresin. *(Dalin.)*

SHKENË III

Një Pjesë Tjatër e Fushës.
Allarmë. Hyjnë KASI dhe TITINI.

KASI.

Oh shih, Titín! Shikó, frikaçët ikin;
U-bësh' armík për njérëzit e mi;
Ky flamur që shikón na hiqej prapa;
E vrava burracakun dhe ia mora.

TITINI

O Kas! Bruti dha urdhrin tepër shpejt;
Se pati ca avanta mi Oktavin,
E mori tepër nxehtë, ushtarët ranë
Mi plaçkë, e né prej Mark Antonit u-rrethuam.

(Hyn PINDARI.)

PINDARI.

Imzót, largóh-u, ikë, ikë tutje!
Antoni tendat t'i zaptój, Imzót;
Largóh-u pra, Imzót! Kas, ikë tutje!

KASI.

Ky breg është mjaft larg. Shikó, Titín;
Tendat e mia jan' ató që digjen?

TITINI

Ató, Imzót.

KASI.

Titín, në më patsh mik,
Kalit m'i hip, e çpo me yzengjí
Gjer sa t'arrísh në ushtërí t'atjeshme
E përsërí të kthehesh të më thuash
Në janë miq apó armíq.

TITINI

Vete dhe kthehem si rrufé. *(Del.)*

KASI.

Dhe ti, Pindar, shko, ngjit-u lart në breg;
Se sy të mirë s'kam; vër re Titinin
Dhe thúajmë çdo gjë që sheh në fushë.

(PINDARI *ngjitet në breg.)*

Si sot kam lindur; koha rrotullój
Dhe ku kam nisur kam për të mbaruar;
M' u-mbýll qarku i jetës. — Ç' kemi, or djalë?

PINDARI.

(Që lártazi.) Oh, Imzót!

KASI.

Ç' po ngjan?

PINDARI.

Titinin e qarkuan rreth e rrotull
Disá kalorës dhe e ndjekin pás;
Aý kalón; taní ment e arrinë;
Ah Titín! ca zbresin; zbriti dhe aý;
E zunë; *(Brohoritje)* dhe dëgjó sí brohoritin.

KASI.

Zbrit poshtë; mos shikó mê tepër.
Oh, burracák që jam! Qýsh rronj akoma
Kur më të mirin mik në sy m' a zunë!
Eja këtú, mor djalë! (PINDARI *zbret.)*
Të zura skllaf një herë në Parthí,
Dhe kur t'a fala jetën, m' u-betove
Që do të bësh çdo gjë që t' urdhërónj.
Eja taní, mbaró atê betím.
Taní je prap' i lirë; dhe m' a merr
Këtê të mirë shpatë, që ia çau

Qesarit barkun, dhe **m' a kall** në **gjoks.**
Mos m' u-përgjíq; këtú, kap dórëzën,
Dhe ja, kështú kur të mbulónj fytyrën,
Shpatën m'a ngul. *(Sulet mi shpatën.)* Qesár, u-çgjakësove
Dhe pikërísht me shpatën që të vrau. *(Vdes.)*

PINDARI.

Ja, jam i lirë; të më kish pyetur,
Kështú nuk do t' a desha. Ah, or Kas,
Larg nga ky vënt Pindari taní ikën
Ku sy Romani të mos e shikonjë. *(Del.)*
(Hyjnë përsëri TITINI *dhe* MESSALA.)

MESSALA.

Si një me një, Titín; Oktavi
U-múnt prej legjiónave të Brutit,
Si ushtëri' e Kasit prej Antonit.

TITINI

Kjo lajmë do t'a ngushëllonjë Kasin.

MESSALA.

Kú e ke lënë?

TITINI

Mi këtê breg, të dëshpëruar fare,
Me ropn' e tij Pindarin.

MESSALA.

Mos ësht' aý atjé, për-dhé i shtrirë?

TITINI

S' duket i shtrir' i gjallë. Oh, moj zëmër!

MESSALA.

Aý nuk është?

TITINI

Jo! aý ka qënë,
Po ky s' është Kasi mê. O díell,
Siç perëndón ti sonte reze-kúq,
Ashtú dhe Kasi perëndój në gjak;
Díell' i Romës perëndój. Shkoj dita;
Re dhe rezike vijnë; puna mori funt.
Dyshimi për suksesin tim e vrau.

MESSALA

Dyshimi për suksésn' e mir' e vrau.
Lajthím i hidhur, bir mellankolie,
Psé mëndjes së përzier i tregón
Gjëra që s' janë? O lajthím, shpejt mbillesh,
Po kurrë nuk' arrín në mirë-lindje
Se e vret nënën që të kap në bark.

TITINI

Kú je Pindár? Kú je, Pindár?

MESSALA

Titín, kërkó-e; unë shkonj e gjenj
Bujarin Brut që t'ia çponj veshët báfas
Me këtê lajmë; që t'ia çponj, po thom;
Se shpat' e mprehtë dhe shigjét' e vrertë
Do t'ishin mê të mirëprítura
Për veshn' e Brutit se kjo lajm' e zezë.

TITINI.

Shko, or Messalë. (MESSALA *del.*)
Unë kërkónj Pindarin n'atê mes.
Përsé më çove tutje, ô trim Kas?
S' t'i hasa miqtë? Dhe s'më vun' atá
Mi krye një kurorë të vijtores
Që të t'a jap? S' dëgjove brohoritë?

Ajmé! i more vesh të gjitha ters.
Ja, merr këtê kurorë përmí krye,
Se Bruti yt m'a dha, dhe unë bënj
Ashtú si m' urdhërój. Ah, eja, Brut,
Dhe shih sí e nderova Kasin tënt. *(Merr shpatën e Kasit.)*
Kështú, ô qjell, ia dó Romanit feja;
Titinit zëmrën, shpat' e Kasit, gjej' a.
(Vret veten. Allarmë. Hyn MESSALA, BRUTI, KATONI I RI, STRATI, VOLUMNI *dhe* LUCILI.)

BRUTI.

Kú, kú, Messalë, është trup' i tij?

MESSALA

Atjé; dhe ja Titini e vajtón.

BRUTI.

Titini e ka përpjetë faqen.

KATONI.

Ka vrarë veten.

BRUTI.

O Jul Qesár, i fortë je akoma!
Shpiritа të vjen rrotull dhe na kthen
Në barkun tonë shpatat.

KATONI.

Trim Titín!
Shikó, e ka kurorëzuar Kasin.

BRUTI.

A ka, si ju, të gjallë dy Romanë?
Oh, lamtumír, i funtm' i gjith' Románëve!
Ësht e pamundur të na lindë Roma
Një shokun tënt. O miq, i detyrónj
Këtí mê tepër lote seç i jap. —
Do t'a gjenj kohën, Kas; pó, do t'a gjenj. —

Taní në Thaso trupin shpjérjani,
Se s' bën në kampin tonë t'a varrosim,
Se mos na dëshpërohet ushtëria.
Eja, Lucíl; eja dhe ti, Katón i Ri;
Në fushë le të shkojmë; Labeón
E Flav, fuqitë prijini përpara:
Ësht ora tri; pa ngrysur, ô Romanë,
Le t'a provojmë për së dyti fatnë. *(Dalin)*

S H K E N Ë I V

Një Pjesë Tjatër e Fushës.

Allarmë. Hyjnë, dyke lëftuar, USHTARË *prej të dy Ushtërive;pastáj* BRUTI,KATONI I RI, LUCI *dhe të Tjerë.*

BRUTI.

Qëndroni édhe, shokë, u bëni ballë!

KATONI.

Kú është doçi që s' qëndrón e s' u bën ballë?
O búrrani, pas meje éjani!
Emrin në fushë do t'a prokllamónj:
Jam bir' i Mark Katonit, éjani!
Jam mik atdheu dhe armík tiranësh;
Jam bir' i Mark Katonit, éjani!

BRUTI.

Dhe unë jam Mark Bruti, unë jam;
Mik i atdhut tim, jam Bruti vetë!
(Del dyke atakuar armikun. KATONI *mundet e bie.)*

LUCILI.

Bujár Katón i Ri, për-dhé m' u-shtrive?
Ja, si Titini, trimërísht më vdiqe,
Me nder, si bir i fjesht' i Mark Katonit.

I PARI USHTÁR.

Jip armët osé vdis.

LUCILI.

Jap armët vetëm që të vdes.
Ja, merr këtó dhe vra-më menjëherë. *(I blatón të holla.)*
Vraj Brutin dhe nderóh-u që e vrave.

I PARI USHTÁR.

S'e kemi lejen; se je rop bujár.

I DYTI USHTÁR.

Largóhuni ! I thoni Mark Antonit
Q' e kemi zënë Brutin rop.

I PARI USHTÁR.

Vete t'ia them; ja, gjenerali vjen. (Hyn ANTONI.)
E kemi zënë Brutin rop, Imzót.

ANTONI.

Kú është?

LUCILI.

Shëndoshë, Mark Antón; shëndoshë mjaft;
Të shigurónj që kurr' asnjë armík
S'e zë bujarin Brut të gjallë rop;
E mproftë qjelli nga ky turp i math!
Dhe kur t'a gjeni gjall' osé të vdekur,
E gjeni burr' e Brut, ashtù siç është.

ANTONI.

Ky s'është Bruti, or shok; po pa dyshím
Nuk e nderónj mê pak. Rúaj-e mirë
Dhe me fisnikërí; t'atijë burra
I dua míq e jo armíq. Eh, shkoni
E shihni, Bruti rron apó u-vrá;
Dhe lajmërómëni çdo gjë që ngjau
Në tendën e Oktavit. *(Dalin.)*

SHKENË V

Nji Pjesë Tjatër e Fushës.

Hyjnë BRUTI, DARDANI, KLITI, STRATI *dhe* VOLUMNI.

BRUTI.

Ejani, ô kusúr i mjer' i miqve,
Dhe çlódhuni mi këtê shkëmp.

KLITI.

Statili na tregónj pishtarín, Zot,
Po s' na u-kthye; u-zú a u-vrá.

BRUTI.

Klit, unj-u sheshit; na e kanë vrarë;
Se ashtú është moda. Klit, dëgjó. *(Pështpëritin.)*

KLITI.

Si? Unë, Imzót? Jo, jo për tërë botën.

BRUTI.

Ahere hesht; mos e bëj fjalë.

KLITI.

Vras veten ca mê mirë.

BRUTI.

Dëgjó, Dardán. *(Pështpëritin.)*

DARDANI.

Unë të bënj t'atillë punë?

KLITI.

Oré, Dardán!

DARDANI.

Eh, Klit!

KLITI.

Ç' të keqe të kërkój Mark Bruti?

DARDANI.

T' a vras, or Klit. Shikó, mejtohet.

KLITI.

Ena bujare u-mbúsh me vrer tanì
Dhe lot nga sytë po m' i derdhen.

BRUTI.

Afróh-u, mik Volúmn; dëgjó një fjalë.

VOLUMNI.

Ç' më the, Imzót?

BRUTI.

Ja ç' thom, Volúmn i dashur.
Fantazma e Qesarit m' është çfaqur
Dy herë natën; tej në Sard një herë,
Këtú, në fushë të Filipit, sonte.
E di që m' ardhi ora.

VOLUMNI.

Jo, jo ashtú, Imzót.

BRUTI.

Kështú, Volúmn, pa fjalë më ka ardhur.
Po i shikón si vanë punët tonja:
Armiqtë na dërrmuan në një gropë;
Më mirë brënda vetë hídhemi
Se sa të presim të na shtyjn' atá.
Volúmn, në shkollë kemi qenë shokë;
Si mik të vjetër që të kam, të lutem,
Shpatën m'a mbaj, të sulem përmí tê.

VOLUMNI.

Imzót, kjo s' është punë për një mik.

(Allarma vazhdón.)

KLITI.

Ikë, ikë, Imzót! mos u-vonó këtú.

BRUTI.

Pra, lamtumirë, ju e ti, Volúmn.
Ti, Strat, ke fjetur tërë këtë kohë;
Strat, lamtumirë, edhé ti. O shokë,
Zëmra m' u-mbúsh me gas, se tërë jetën
Kurrë një shok s' më dolli i pabesë.
Fitónj pra sot lavdí më tepër
Se sa Oktáv' i ri e Mark Antoni
Nga kjo vijtore faqe-zéz' e tyre.
Pra, lamtumirë, shokë; gjuh' e Brutit
Ment ia ka mbyllur historín' e jetës:
M' u-errë sytë; eshtrat, që m' u-lodhë
Gjer sa t' arrínj këtú, më lypin prehje.

(Allarmë. Thirrje përbrënda: „Ikë, ikë, ikë!")

KLITI.

Ikë, Imzót, ikë.

BRUTI.

Shkoni përpara, vinj më pás.

(*Dalin* KLITI, DARDANI *dhe* VOLUMNI.)

Të lutem, Strat, rri pranë zotit tënt;
Je një njerí me emër të qëruar,
Dhe jeta t' është ngjyer me ca nder;
M'a mbaj pra shpatën, dhe kthe faqen prapa,
Të rent mi të. A m' a bën dot, ô Strat?

STRATI.

Më parë nem'a dorën. Lamtumirë, Imzót.

BRUTI.

Bir, lamtumirë! — *(Sulet mi shpatën e tij.)*
Rri, Qesár, taní i qetë;

S' të vrava as me gjysmë zjarr sa vritem vetë. *(Vdes.)*
(Allarmë. Ritiratë. Hyjnë OKTAVI, ANTONI, MESSALA, LUCILI, *dhe* USHTËRIA.)

OKTAVI.

Kúsh ësht' aý njerí?

MESSALA.

Djal' i tim-zoti. Strat, kú ësht' yt-zót?

STRATI.

I lirë nga vargónjt' e tu, Messalë,
S' ka ç' i bën múndësi veç zjarr t'a djegë,
Se vetëm Bruti e përmbysi veten
Dhe asnjerí s' lëvdohet dot q' e vrau.

LUCILI.

Kështú duhej t'a gjenim. Brut, të falem
Që m'a provove të vërtetë fjalën.

OKTAVI.

Të gjithë djemt' e Brutit i marr pás.
Ti, djalë, á deshërón të vish pas meje?

STRATI.

Vinj, n' urdhërófť ashtú Messala.

OKTAVI.

I thuaj pra, Messál' i dashur.

MESSALA.

Sí vdiq yt-zót, or Strat?

STRATI.

Ia mbajta shpatën dhe u-súl mi të.

MESSALA.

Ahere, Oktáv, merr-e pas teje djalin,
Q' i bëri zotit tim shërbimn' e funtmë.

ANTONI.

Ky ish Romani mê bujár së gjithësh:
Të tjerët që të gjithë, veç këtí,
E bën' atê që bënë nga zilia
E Jul Qesarit math; ky vetëm, ky
Me një qëllím të nderçim e të kthjellët
Dhe për të mirën e përgjíthëshme
U-líth me tá. I ëmbël ish në jetë
Dhe kish në shpirt t'atija elementa
Sa munt të ngrihej e t' i prokllamonte
Natyra tërë botës: „Ky ish burrë!"

OKTAVI.

Le t'a përdorim pas virtytit tij,
Me pomp' e çdo respékt le t'a varrosim.
Në tendë trupin sonte síllmjani,
Si një ushtár, me nder e të stolisur.
Tanì të flenë trimat; dhe né shkojmë
Lavdít' e ditës lumur të gëzojmë. *(Dalin.)*

FUNT

E shqipëroj
FAN S. NOLI

Për Shtëpin botuese
REMZI SHAHSIVARI

Redaktori teknik
JANI GJINO

Korektoi në shtyp
ALI REXHA